



VETERANI

GAZETË PERIODIKE. NR.5(431)

MAJ 2024

ÇMIMI: 30 LEKË



Drejtor: MUHARREM GJOKA; Kryeredaktor: HALIL RAMA ; Zv/Kryeredaktor: SAKIP CAMI & BASHKIM HISARI ; website: www.VETERANIOBVL.ORG

5 MAJ

LAVDI PËRJETË DËSHMORËVE TË ATDHEUT!

SHQIPTARËT NDEROJNË DËSHMORËT E KOMBIT TË TË GJITHA KOHËRAVE



Muharrem GJOKA – Mjeshtër i Madh **FAQE 3**

105 VJETORI I LINDJES

RRAHMAN PARLLAKU VEND NDERI NË LËVIZJEN ANTIFASHISTE NË VLORË



Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj **FAQE 7**

KUMTESA

NJË JETË PLOT DINJITET NË SHËRBIM TË KOMBIT



SHPENDI TOPOLLAJ **FAQE 6**

OBVL, Akademi përkujtimore në 105 vjetorin e lindjes së gjeneralit që bëri epokë

NDERIMI PËR “NDERIN E KOMBIT” RRAHMAN PARLLAKU

OPINION

Testamenti i atdhedashurisë

Halil RAMA

Me 17 prill 2024, familja, të afërmit dhe miqtë tuj të shumtë, përkujtuan gjeneralin legjendë në kufirin e tri kohëve, Rrahman Parllaku - Hero i Popullit dhe Nderi i Kombit, në 105-vjetorin e ditëlindjes së tij. Pesë vjet më parë, kur sapo kishte mbushur një shekull jetë, atij ju festua me madhëshi ditëlindja jubilarë shekullore me disa veprimtari të larmishme. E meritonte, sepse Ai vinte në kapërcyellin e shekullit të jetës së tij, me profilin e burrështetësit me bukuri të rrallë fizike...

FAQE 10



- Në spiralet e historisë, gjeneral Parllaku ka ditur të lakohet me dinjitet, duke pasur si kolonë bazë përkushtimin kombëtar shqiptar dhe progresin shoqëror, si thelb i motivimit që gëlonte shpirtin e tij progresist e liridashës
- Vlerësime nga gjeneralmajor Manushaqe Shehu, deputeti Flamur Noka, Nënkryetarja e Bashkisë Tiranë Jonida Halili, veteranët e LANÇ të Kosovës, “Bijtë e Shqipes” të Filadelfias –SHBA etj...

FAQE 3

KULTURË

Iballa sipas albanologut të shquar HAHN



Johann Georg von Hahn

Xhemal MEÇI

FAQE 13

80-VJETORI

KONGRESI I PËRMETIT, PIKË KULMORE NË HISTORINË SHQIPTARE

FAQE 2

IN MEMORIAM

I PËRJETSHËM KUJTIMI I PËRPARIM HYSENIT

FAQE 4

110 VJETORI

KUVENDI I SHTËPËZIT BESË E SHPRESË PËR SHQIPËRINË

Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

FAQE 12

KUJTESË

RA KY MORT E U PAMË PËR PROFESOR KRISTAQ MUSKËN

Sefer PASHA

FAQE 14

73 VJETORI

KRENARIA E SHQIPONJAVE TE AJRIT

Nga GJIN MUSA

FAQE 15

Publicistika e gjeneral Parllakut

Sakip CAMI

FAQE 3-6

FIGURË EMBLEMATIKE E SHQIPËRISË...

Nga Nikolla Sudar

FAQE 11

RRAHMAN PARLLAKU, DRITË E LIRISË

Elegji nga

MEVLUD BUCI

FAQE 11

80-VJETORI

Kongresi i Përmetit, pikë kulmore në historinë shqiptare

NGA FATMIR FEZGA - TEXAS, USA

Më 24 maj 1944 filloi punimet në Përmet Kongresi I Antifashist i Lëvizjes Nacionalçlirimtare shqiptare. Ne terminologjinë e shkurtuar historike, ky kuvend kombëtar njihet si Kongresi i Përmetit.

Kongresi ishte një nga ngjarjet më të rëndësishme dhe decizive të luftës antifashiste të popullit shqiptar, një kuvend që riformatoi dhe çimentoi vendimet dhe idetë paraprake që ishin hedhur në Konferencën e Pezës në shtator të vitit 1942.

Për më tepër, duke u mbështetur në hovin dhe iniciativën që kishte fituar tashmë lufta e repartëve partizane në veçanti dhe Lëvizja Antifashiste në Shqipëri; Kongresi i Përmetit saktësoi direktivat për kalimin në stadin final të kësaj lufte, çlirimin e plotë të atdheut.

Vizioni i Kongresit shkoi përtej çlirimit të vendit, duke hedhur themelet për mënyrën e qeverisjes dhe duke përcaktuar se kush do të ishte forca që do të merrte në dorë pushtetin në Shqipërinë e lirë, pas shporrjes së pushtuesve gjermanë.

Natyrisht, me vendimet e rëndësishme që ndikuan në jetën dhe fatet e Shqipërisë për dekada të tëra nga ajo ditë, Kongresi i Përmetit ka zënë një vend të rëndësishëm në historinë shqiptare të pasluftës dhe në kujtesën e mbarë popullit shqiptar. Padyshim duhet përmendur se për shkak të kësaj ngjarjeje historike, 24 maji zuri një vend të veçantë në kujtesën e popullit të Përmetit.

Është normale krenaria e përmetarëve si banorë të qytetit që mirëpriti delegatët dhe udhëheqjen e Lëvizjes Nacionalçlirimtare (LNÇ); njëkohësisht ata kontribuuan me të gjitha mundësitë e tyre për të siguruar mbarëvajtjen e punimeve të Kongresit.

Qysh nga viti 1944 në nderim të vendimeve të Kongresit Antifashist, ajo ditë u kthye në një festë popullore të përvitshme në Përmet.

KUSHTET POLITIKO-USHTARAKE PËR THIRRJEN E KONGRESIT TË PËRMETIT

Lëvizja Nacionalçlirimtare (LNÇ) dhe Ushtria Nacionalçlirimtare shqiptare (UNÇSH), ose forcat partizane, përballuan me sukses operacionin e dimrit (1943-'44), që ishte një mësymje e koordinuar kundër tyre nga ushtria pushtuese gjermane dhe kolaboracionistët vendas. Propaganda e ushtrisë gjermane dhe ajo e qeverisë kuislinge të Tiranës deklarorin në këtë kohë se rezistenca antifashiste dhe lufta partizane ishin asgjësuar.

Në të vërtetë, me gjithë humbjet që pësoi nga ky operacion, UNÇSH mbijetoi dhe u konsoliduar si forcë e rëndësishme luftarake. Në fillimet e pranverës 1944 ajo filloi të zgjerohej me shpejtësi dhe po shtrihej në të gjithë territorin shqiptar. Kështu, nga janari në maj të atij viti, UNÇSH-së iu shtuan brigada të tjera partizane e disa batalione e çeta lokale.

Vrullin e rritjes së lëvizjes partizane në këtë periudhë e përshkruan me përshtypje të veçantë në kujtimet e tij edhe oficeri i misionit aleat britanik në Shqipëri, kapiteni R. Hibbert. Në librin e tij "Fitortorja e hidhur", që është botuar në vitin 1991, ai shkruan: "Zgjerimi i forcave partizane ose UNÇSH në pranverë ishte një dukuri e jashtëzakonshme, që i habiti oficerët e misionit britanik, të cilët kishin qenë dëshmitarë të situatës së rrezikshme që kishte kaluar bërthama e forcave partizane vetëm dy-tre muaj më parë". Me luftën e saj të ashpër kundër pushtuesit, organizimin e lartë dhe qëndrimin dashamirës ndaj popullit, UNÇSH fitoi besimin dhe mbështetjen popullore në Shqipëri.

Ajo shihej si e vetmja forcë shqiptare që luftonte për çlirimin e vendit, ringritjen e flamurit shqiptar dhe mbrojtjen e aspiratave e të të drejtave për



shumicën e popullsisë shqiptare. Të rinjtë dhe të rejtat shqiptare vërshuan dhe shtuan me shpejtësi rreshtat e formacioneve partizane.

Në fund të pranverës së vitit 1944 iniciativa ushtarake në Shqipëri kaloi në dorën e Ushtrisë Nacionalçlirimtare shqiptare; gjermanët dhe forcat kolaboracioniste u mbyllën kryesisht në garnizonet e qyteteve, sidomos në Shqipërinë e Jugut. Në planin ndërkombëtar situata gjithashtu ishte optimiste për koalicionin antifashist që udhëhiqej nga tri Fuqitë e Mëdha: Bashkimi Sovjetik, Anglia dhe SHBA.

Në përputhje me këtë situatë optimiste; për të bërë bilancin e arritjeve të LNÇ dhe për të përcaktuar objektivat dhe platformën për vazhdimin e mëtejshëm të luftës çlirimtare dhe qeverisjen e vendit, Kryesia e Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar vendosi, me 15 prill 1944, thirrjen e Kongresit Antifashist të Përmetit.

PROCEDURA DEMOKRATIKE E ZGJEDHJES SË DELEGATËVE

Është me mjaft interes të përmendet se megjithëse LNÇ operonte në situatë lufte, idetë dhe vendimet për realizimin e zgjedhjeve ishin ide të përparuara e mjaft demokratike.

Në rezolucionin e Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar për zgjedhjen e delegatëve theksohej:

"Në kongres të përfaqësohen zonat e lira, zonat e pushtuara nga armiku, brigadat dhe batalionet partizane e vullnetare, Bashkimi i Rinisë Antifashiste me 10 delegatë dhe Bashkimi i Gruas me 5 delegatë". Në zonat e çliruara dhe formacionet e ushtrisë delegatët do të zgjidheshin demokratikisht, me votim të hapur, kurse në zonat e paçliruara do të caktoheshin nga këshillat e qarqeve apo të qyteteve.

Haxhi Lleshi, i cili ishte një nga udhëheqësit kryesorë të LNÇ, e përshkruan natyrshëm në kujtimet e tij një episod që tregon se si u zgjodhën në mënyrë demokratike, në një miting të hapur, përfaqësuesit e popullit në komunën e Plashnikut (qarku i Beratit), ku ai ishte i dërguar në atë kohë (prill 1944) për të ndjekur zgjedhjet: "Përshtypje të veçante më ka lenë mbledhja që u organizua në Plashnik, ku morën pjesë rreth 500 vetë e midis tyre afro 100 gra.

U emocionova kur pashë këtë pjesëmarrje të gjerë, mendova sa lart ishte ngritur vetëdija patriotike, an-

tifashiste dhe demokratike e mbarë popullit që po merrte pjesë jo vetëm për fitoren e luftës kundër pushtuesit e tradhtarëve, por edhe për formimin e pushtetit të ri, tek i cili ai kishte mbështetur shpresat e të nesërme....

Aty folën edhe aktivistë, burra e gra, të rinj e të reja. Në diskutimet e tyre shprehej përkrahje e plotë për LNÇ dhe thirrjen e Kongresit I Antifashist. Në fund pjesëmarrësit zgjodhën demokratikisht delegatët për në konferencën nacionalçlirimtare të qarqut". Përfundimisht, megjithëse në kushtet e vështira të luftës me pushtuesit, u zgjodhën 200 delegatët e Kongresit I Antifashist, të cilët përfaqësonin të gjitha shtresat e popullsisë shqiptare dhe mbulonin gjithë territorin shqiptar.

Aty kishte delegatë nga Partia Komuniste Shqiptare (PKSH), përfaqësues nga shtresat nacionaliste, nga ushtria partizane, nga Bashkimi i Rinisë Antifashiste dhe Bashkimi i Grave të Shqipërisë. Forumet drejtuese të LNÇ dhe PKSH kishin marrë vendimin që Kongresi të mbledhej në qytetin tashmë të çliruar të Përmetit.

VENDIMET E KONGRESIT TË PËRMETIT

Kongresi antifashist i Përmetit, duke pasur parasysh përbërjen gjithëpërfshirëse të delegatëve të tij dhe përfaqësimin e tyre territorial, ishte një kuvend kombëtar apo një asamble kushtetuese që kishte misionin të zgjidhte organet legislative dhe ekzekutive, të cilat do të qeverisnin vendin deri në mbarim të luftës dhe më pas, në Shqipërinë e çliruar. Ashtu siç dihet nga dokumentet historike, kongresi zgjodhi së pari Këshillin e Përgjithshëm Nacionalçlirimtar (KPNÇ) si organin më të lartë shtetëror; forumin kryesor ligjvënës, përfaqësuesin e vetëm sovran të popullit shqiptar.

KPNÇ zgjodhi Kryesinë e Këshillit të Përgjithshëm që përbëhej nga 25 anëtarë; president i saj u zgjodh Omer Nishani. Së treti, në Kongres u zgjodh dhe Komiteti Antifashist Nacionalçlirimtar, i cili kishte atributet e një qeverie provizore. Ky komitet, apo qeveri provizore, përbehej nga 11 anëtarë.

Sekretari i përgjithshëm i PKSH-së, Enver Hoxha, u emërua kryetar i qeverisë provizore, kurse nacionalisti i mirënjohur Myslim Peza u emërua nënkryetar i qeverisë provizore. KPNÇ, si organ ligjvënës, qysh në formimin e tij gjatë ditëve të Kongresit, nxori aktet apo vendimet e para të rëndësishme, të cilat patën një rëndësi të madhe për zhvillimin e mëtejshëm të luftës çlirimtare dhe pavarësinë e Shqipërisë në vitet e mëvonshme.

Vlen të përmenden tri vendimet e mëposhtme, të cilat lanë gjurmë të pashlyeshme në jetën politiko-ekonomike të Shqipërisë dhe përcaktuan drejtimin që do të merrte shteti i ardhshëm shqiptar:

- Të ndërtohet Shqipëria e re demokratike e popullore sipas vullnetit të popullit.
- T'i ndalohet ish-Mbretit Zog kthimi në Shqipëri dhe të mos njihet asnjë qeveri që mund të formohet brenda ose jashtë vendit kundër vullnetit të popullit.
- Të vazhdohet më me ashpërsi lufta kundër pushtuesve gjermanë dhe tradhtarëve shqiptarë, deri në shkatërrimin e tyre të plotë dhe vendosjen e pushtetit demokratik-popullor në të gjithë vendin.

Vendimet e Kongresit të Përmetit treguan se LNÇ dhe PKSH, si forca kryesore lëvizëse e saj, kishin krijuar bindjen se ato do të ishin fituesit e luftës dhe do të qeverisnin vendin pas fitores. Megjithëse ca vëzhgues të huaj e quanin si vetëbesim të tepruar optimizmin e drejtuesve të LNÇ në atë kohë, ngjarjet e mëvonshme vërtetuan se analiza e situatës që beri PKSH dhe LNÇ ishte racionale dhe realiste.

Kongresi i Përmetit duke shpallur person "non grata" ish-Mbretin Zog i vuri atij legalisht damkën e tradhtarit, sepse ai e ktheu Shqipërinë në shtet vasal të Italisë dhe braktisi popullin e vendin (bashkë me shpurën e qeveritarëve të tij) në ditët e vështira të pushtimit fashist.

Gjithashtu, vendimet e këtij Kongresi u dhanë një mesazh të qartë kuislingëve dhe kolaboracionistëve

(Vijon në faqen 3)

5 MAJ

SHQIPTARËT NDEROJNË DËSHMORËT E KOMBIT TË TË GJITHA KOHËRAVE

Lavdi përjetë dëshmorëve të atdheut!

Muharrem GJOKA

Mjeshtër i Madh & Nënkyetar i OBVL

Çdo 5 maj, Shqipëria, si të gjithë kombet e qytetëruar nderon dëshmorët e saj.

5 Maji është një ditë kujtese dhe nderimi për Qemal Stafën dhe mijëra të rinj e të reja që dhanë jetën për kauzën e Lirisë. Vrasja në 5 Maj 1942 e Qemal Stafës, ish sekretari politik i të rinjve komunistë, në nderim të veprës së tij, është caktuar të jetë Dita e Dëshmorëve.

Respekti dhe nderimi për dëshmorët është shenjë e pjekurisë dhe fuqisë së një kombi. Respekti për të kaluarën është një investim për të ardhmen.

Çdo 5 maj përulemi me respekt para dëshmorëve që ranë për pavarësinë e Shqipërisë.

Para patriotëve që kanë dhënë jetën për mbrojtjen e integritetit territorial, trojeve, lirisë e pavarësisë së atdheut.

Para 28 mijë dëshmorëve partizanë që dhanë jetën për çlirimin e Shqipërisë. Përulem para kujtimit të luftëtarëve partizanë të huaj që ranë për çlirimin e Shqipërisë. Çdo 5 maj përulemi para dëshmorëve të Shqipërisë që dhanë jetën duke luftuar për çlirimin dhe pavarësinë e Kosovës. Para oficerëve e policëve dëshmorë të rënë në krye të detyrës, të cilët i kujtojmë e nderojmë bashkë me fëmijët dhe familjet e tyre. Para vajzave e djemve të Shqipërisë që kanë dhënë jetën gjatë misionëve paqeruajtës të NATO-s, në mbrojtje të lirisë së popujve të tjerë dhe të mbrojtjes së paqes e sigurisë nga terroristët.

Para dëshmorëve të kohës sonë që kanë rënë në krye të detyrës për mbrojtjen e jetës së qytetarëve nga krimi dhe mbrojtjen e pronës publike nga fatkeqësitë natyrore.

Kongresi i Përmetit, pikë kulmore në historinë shqiptare

(Vijon nga faqja 2)

ballisto-zogistë; nuk do të kishte pushtet në tavolinë për ata që bashkëpunonin me armikun dhe as për ata që prisnin të ikte pushtuesi e pastaj "të luftonin".

Pushteti u takonte atyre që luftonin kundër pushtuesit për çlirimin e Shqipërisë dhe do të mbronin lirinë, të drejtat, interesat dhe aspiratat demokratike të popullit shqiptar. Në zbatim të vendimit të Kongresit për çlirimin e plotë të Shqipërisë, Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSH-së, me 28 maj 1944, nxori urdhrin për fillimin e ofensivës së përgjithshme ushtarake.

Në këtë kuadër, Divizionit I S, i cili sapo ishte formuar, iu komunikua detyra të kalonte Shkumbinin dhe të mësynte forcat gjermane dhe bashkëpunëtorët e tyre vendas në Shqipërinë e Mesme dhe Shqipërinë Veriore. Marshimi i Divizionit I drejt Veriut ishte një moment kyç në luftën për çlirim.

Ai tregoi se tani UNÇSH ishte e aftë për të luftuar pushtuesit në çdo zonë të Shqipërisë, kishte marrë iniciativën luftarake kundrejt armikut dhe së shpejti objektivi i saj do të ishte çlirimi i qyteteve, përfshirë edhe Tiranën. Përfundimisht, edhe sot pas 80 vitesh, mbështetur në kohën kur u mbajt dhe vendimet e rëndësishme të tij, mund të thuhet se Kongresi i Përmetit zë një pikë kulmore në historinë shqiptare.

Aty u përcaktuan drejtimit për të realizuar qëllimin final të Luftës Antifashiste të popullit shqiptar: çlirimin e plotë të atdheut nga pushtuesit nazifashistë, garantimin e një Shqipërie të lirë e sovranë në mbarim të Luftës së Dytë Botërore dhe vendosjen e pushtetit popullor.

(Marrë nga gazeta "Panorama")

Çdo kohë ka dëshmorët e saj dhe ne i nderojmë ata duke punuar çdo ditë për idealet e tyre, për Shqipërinë.

Dëshmorët nuk janë më fizikisht. Por me ne janë idealet dhe vepra e tyre. Nuk janë më nënat e dëshmorëve të Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare, por janë mbesat, nipat e stërnipat e tyre. Janë fëmijët e oficerëve dhe policëve të rënë në krye të detyrës. Janë fëmijët, nënat, motrat e vëllezërit e vajzave e djemve të rënë për lirinë e kombeve të tjera, të rënë në luftën kundër terrorizmit e krimit, në luftën për mbrojtjen e qytetarëve dhe pronës publike.

Në 5 maj i gjithë Atdheu mban frymën në respekt të pafund për të rënë për atdheun, martirët e kombit që sakrifkuan jetën e tyre e në emër të Shqipërisë.

Lufta për çlirimin e atdheut gjaku i derdhur, jetët e flijuara dhe sakrificat sublime për lirinë e tij, janë gdhendur si dëshmia monumentale e një populli që ka luftuar në mënyrë të paepur me pushtuesit gjatë gjithë historisë së tij.

Nderimi ndaj dëshmorëve, është nderim për historinë e popullit, por është edhe një referencë krenarie, që na frymëzon për ta mbajtur të shenjtë amanetin e tyre, Shqipërinë e lirë, shtëpinë tonë të përbashkët!

Lavdi përjetë dëshmorëve të atdheut!



80 VJETORI

Brigada e 12-të Sulmuese la në altarin lirisë 105 dëshmorë

Brigada e 12 Sulmuese u krijua në zjarrin e Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare. Ishte maj i vitit 1944, kur partizanët shqiptarë po vulosnin me betejat dhe gjakun e tyre fitoren e kësaj lufte çlirimtare, antifashiste, patriotike dhe emancipuese për Shqipërinë dhe kombet e qytetëruara.

Ishte 20 maji 1944, kur 600 partizanë e partizane të ardhur nga Zona e Parë Operative Vlorë-Gjiro-kastër, në Sukë krijuan Brigadën e 12, nën drejtimin e Komandantit Refat Bajrami dhe Komisarit Qemal Klosi, dy personalitete të shquar të Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare.

Brigada e 12 ka shumë merita lufte, trimërie dhe heroizmi. Por kjo Brigadë ka edhe një meritë të veçantë, që e dallon nga formacionet e tjera të Ush-

trisë partizane: numrin shumë të madh të vajzave luftëtare. Rreth 200 vajza ose 30 përqind e luftëtarëve të Brigadës ishin vajza.

Kjo rrethanë zbulon një tipar tjetër të vlerave antifashiste: lidhjen e tyre me vlerat shoqërore dhe kulturore emancipuese. Antifashizmi nuk ishte vetëm çlirimi prej pushtuesve nazistë e fashistë, por hapi rrugën për progres të gjithanshëm politik, shoqëror e kulturor në gjithë botën e qytetëruar.

Prej këtij progresi nuk përfituan vetëm kombet fituese, por të gjitha kombet, të gjithë vendet dhe të gjithë popujt.

Brigada e 12 ka një bilanc të pasur betejash e fitoresh. Pas përfundimit të Kongresit të Përmetit, luftëtarët e saj shkruan faqe heroizmi e lavdie në luftimet e Qafës së Këçokut, në Tepelenë, Kurvelesh, Vlorë, Llogara, Himarë, Therepel, Vokopolë, Rehove etj. Njësitë të saj u takon merita e çlirimit të Sarandës, Vlorës, Sazanit, Peqinit, Rrogozhinës, Kavajes, Durrësit e Shijakut.

Brigada e 12-të Sulmuese la në altarin lirisë 105 dëshmorë, të cilët i kujtojmë sot me respekt e nderim të thellë.

Trimëria legjendare e djemve dhe vajzave të Brigadës së 12 nuk përfundoi më 29 nëntor 1944. Ju, veteranët e saj, pasardhësit tuaj dhe familjet e dëshmorëve të lirisë kini mbajtur e mbani gjallë frymën antifashiste, patriotike, progresiste dhe europiane të luftëtarëve të saj.

Dekoratat që ndrisin në gjokset tuaja janë mirënjohje dhe dëshmi e një epopeje nga më të lavdishmet në historinë tonë kombëtare, të devocionit e sakrificave sublime në shërbim të Atdheut, lirisë dhe progresit. Shkëlqimin e tyre nuk ka argument apo pseudo-historian që ta mohojë.

Antifashizmi, atdhetarizmi, përkushtimi e sakrificat për liri e progres nuk vjetrohen kurrë.

Këto vlera qëndrojnë në themel të Europës dhe qytetërimit të sotëm perëndimor.



SPECIALE

OBVL, Akademi përkujtimore në 105 vjetorin e lindjes së gjeneralit që bëri epokë

NDERIMI PËR “NDERIN E KOMBIT” RRAHMAN PARLLAKU

Halil RAMA – Mjeshtër i Madh

Heroi i Popullit Rrahman Parllaku, në 105 vjetorin e lindjes është përkujtuar si memoria historike e kombit.

Në Akademinë Përkujtimore që Organizata e Bashkuar e Veteranëve të LANÇ (OBVL) mbajti më 20 prill 2024 në Akademinë e Shkencave, me moderimin e Mjeshtër të Madh Dëfrim Methasani, përveç Veteranëve e pasardhësve të tyre, familjarëve, miqve dhe të afërmëve të të paharruarit general Parllaku, merrnin pjesë dhjetra personalitete ushtarake, të politikës e letrave, si Namik Dokle, Pëllumb Xhufi, general. Piro Ahmetaj, Shaqir Rexhvelaj, Tefta Cami, Mjeshtër i Madh Muharrem Gjoka, historian Xhemal Meçi – Mjeshtër i Madh, nënkryetarja e OBVL Miraja Ohrikol. Ali Demushi, akademik Fatos Daci, etj.

Pas dokumentarit “Gjenerali që bëri epokë”, që u ndoq me interes të veçantë, të pranishmit u përshëndetën nga: Gjeneral major Manushaqe Shehu - Zv/ Shef i Shtabit të Përgjithshëm të FA të RSH; Flamur Noka – deputet & Sekretar i Përgjithshëm i PD; Jonida Halili – Nënkryetare e Bashkisë Tiranë; Lekë Hoxha - Kryetar i Org. Veteranëve të LANÇ të Kosovës; Enver Parllaku - Përfaqësues i Shoqatës “Bijtë e Shqipes” të Filadelfias SHBA, Prof. Dritan Spahiu - Kryetar i Shoqatës Luma, ish - ministria e Arsimit dhe Kulturës Tefta Cami, etj.

Jeta dhe vepra heroike e gjeneral Parllakut, si organizator dhe drejtues i talentuar i LANÇ dhe Ushtrisë Shqiptare, qëndresa në burgjet e diktaturës dhe publicistika e tij, u përçuan më së miri nga kumtesat që mbajtën: Prof. asoc. dr. Bernard Zotaj dhe shkryetarët e publicistët Shpendi Topollaj, Sakip Cami dhe Nikolla Sudar.

E përbashkëta në fjalët përshëndetëse dhe e trajtesave që u mbajtën në këtë Akademi Përkujtimore, që përcjellja te publiku konkluzioni se, në spiralet e historisë, gjeneral Parllaku ka ditur të lakohet me dinjitet, duke pasur si kolonë bazë përkushtimin kombëtar shqiptar dhe progresin shoqëror, si thelb i motivimit që gëlonte shpirtin e tij progresist e liridashës.

Vështirë të përmbledhësh në pak radhë, në kuintesencë, motivimin e personalitetit të tij, zhvillimin konjitiv e psikomotor të këtij djaloshi që



- Në spiralet e historisë, gjeneral Parllaku ka ditur të lakohet me dinjitet, duke pasur si kolonë bazë përkushtimin kombëtar shqiptar dhe progresin shoqëror, si thelb i motivimit që gëlonte shpirtin e tij progresist e liridashës
- Vlerësime nga gjeneralmajor Manushaqe Shehu, deputeti Flamur Noka, Nënkryetareja e Bashkisë Tiranë Jonida Halili, veteranët e LANÇ të Kosovës, “Bijtë e Shqipes” të Filadelfias –SHBA etj...

ngjitej nga Novosej i Kukësit në Tribuna të larta shtetërore, në hero të popullit të tij, në drejtues madhor ushtarak, duke ndryshuar variablat në kontekste politike në funksion të mbijetesës dhe qëndresës, nga udhëheqës i shquar në të dënuar me burg, nga triumfator në grigjë të rrezikut për jetën, nga piedestali i kuadrit të dobishëm në stigmën e “njeriut të rrezikshëm”, ekstreme këto që provokuan në personalitetin e tij, qëndrime dhe vlera të larta politiko-shoqërore në raportin e ndjenjave të forta estetike midis dashurisë dhe urrejtjes. Këtë volem ideor dhe estetik e përcolli përgjatë shekullit të jetës së tij, një burrë shtetar, një organizëm vital, një mendje koherente dhe një

vizion largpamës dhe perspektiv.

Kjo Akademi Përkujtimore u pasqyrua edhe nga televizionet publike kombëtare Top chanel e Ness 24.

Më poshtë vijojnë disa nga përshëndetjet në këtë Akademi përkujtimore për Nderin e Kombit Rrahman Parllaku.



Gjeneralmajor MANUSHAQE SHEHU:

Burrështetasi që sfidoi kohët dhe regjimet

Eprita me kënaqësi të veçantë ftesën e OBVL për të qenë e pranishme në këtë event të rëndësishëm.

Përkujtimore të tilla kushtuar një personaliteti të rrallë, si komandanti legjendar i LANÇ dhe drejtuesi i talentuar i Ushtrisë sonë, janë vërtetë një ngjarje e shënuar, jo vetëm për ne në këtë sallë, por për gjithë shqiptarët.

Për mua si drejtuese e Ushtrisë që një rast fatlum dhe unik, krejt e veçantë dhe emocionues padyshim, që e njoha nga afër gjeneral Parllakun dhe mësova shumë prej tij.

Rrallë gjen shembuj të personalitetit ku të jenë jetësuar në mënyrë kaq mjeshtërore vetitë e karakterit të një patrioti, të një ushtaraku të mençur, fisnik, të ndershëm dhe patriot, si tek ky Hero i Luftës dhe Ushtrisë që e përkujtojmë sot në 105 vjetorin e ditëlindjes së tij.

Rrugëtimin mbi shekullor të jetës, Gjeneral Parllaku e ka përshkruar përmes fjalës e veprës së tij, duke mbetur një monument e pasuri kombëtare e pa eksploruar plotësisht.

Ne krenohemi me të, pasi në jetën dhe veprën te tij janë ulur këmbëkryq urtësia e burrit të malësisë, trimëria, shpirti i lirisë dhe atdhedashuria e luftëtarit antifashist dhe e komandantit partizan, si dhe angazhimi qytetar plot përkushtim.

Të tillë do ta përkujtojmë gjithmonë këtë burrështetas që sfidoi kohët dhe regjimet, me përkushtimin ndaj kombit, i pathyeshëm në betejat që iu imponuan apo i zgjodhi që të bënte përgjatë mbi 100 viteve të jetës së tij.

I përjetshëm kiuajtimi i gjeneralit fitimtar të tri kohëve Rrahman Parllaku – Hero i Popullit dhe nderi i Kombit.

LAVDI!

HISTORIA



JONIDA HALILI – Nënkyetare e bashkisë Tiranë:

Gjeneral Parllaku “SIMBOLI I QYTETIT TË TIRANËS”

Kam kënaqësinë e veçantë që në këtë Akademi Perkujtimore në 105-vjetorin e lindjes të Heroit të Popullit Rrahman Parllaku, t’ju sjell përshëndetjen e kryetarit të Bashkisë Tiranë, Erion Veliaj.

Pesë vjet më parë, në 100 vjetorin e ditëlindjes së tij, ndërsa i ka dhënë titullin “SIMBOLI I QYTETIT TË TIRANËS”, kryebashkiaku Veliaj është shprehur se “Ka heronj dhe mbi heronj, por gjeneral Rrahman Parllaku mbetet mbi të gjithë një hero i gjallë dhe krenari e qytetit. Ai është një nga figurat emblematike të Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare, që sfidoi edhe regjimin e diktaturës komuniste”. Qytetarët e Tiranës janë krenarë me këtë patriot që luftoi fashizmin, me këtë figurë emblematike të Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare, me gjeneralin që sfidoi regjimin e diktaturës komuniste, dhe me Heroin e Popullit, titull që diktatura komuniste ia hoqi, por historia ia përjetësoi.

Ne jemi krenarë që kemi “Simbol të Qytetit” gjeneral Parllakun që ishte dhe mbeti simbol ikujtesës patriotike, qytetare dhe historike...”

Pikërisht për këto vlera, me vendimin e Këshillit Bashkiak të Tiranës, një rrugë kryesore e kryeqytetit mban emrin “Rruga Gjeneral Rrahman Parllaku”.

Kështu Ai është përjetësuar në kujtesën tonë, në kujtesën e të gjithë qytet-



arëve të Tiranës si simbol i saj. Le ta përkujujmë si të tillë edhe në këtë ditëlindje të 105-të. I përjetshëm qoftë kujtimi i tij. Lavdi jetës dhe veprës heroike të gjeneralit legjendaf Rrahman Parllaku!

LEKË HOXHA: Kosova e nderon Parllakun si gjeneral legjendar



Sa qe gjallë, gjeneral Parllaku ka ardhë disa herë në Prishtinë, Prizren e Gjakovë. Në takimet

përkujtimore, sëbashku me prindërit e mi, Fadil e Vahide Hoxha që drejtuan Organizatën e Veteranëve të LANÇ të Kosovës, kanë dhënë mesazhin e domosdoshmërisë të mbrojtjes dhe promovimit të Luftës së lavdishme Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Këto mesazhe i ka përcjellë, jo vetëm në takimet e përbashkëta të dy organizatave tona, por edhe në media, në televizionet e Shqipërisë e të Kosovës, si dhe në librin e tij “Kosova e lirë, ëndrra e jetës sime”. Në Kosovë, Rrahman Parllaku e prisnin dhe e nderonin si gjeneralin legjendar që drejtoi Ushtrinë Partizane në luftën për çlirimin e Shqipërisë e të Kosovës, si fitimtarin e tri epokave.

Ai ishte dhe mbetet simbol i luftëtarit e drejtuesit të talentuar të luftës partizane, simbol i ushtarakut model, simbol i atdhetarit të flaktë që mishëronte dhe përconte vlerat më të mira njerëzore dhe intelektuale.

Si të tillë do ta kujtojmë e nderojmë gjithmnë general Parllakun.

ENVER PARLLAKU: “Bijtë e Shqipes”, të Filadelfias në SHBA krenohen me gjeneralin legjendë në kufirin e tri kohëve

Në emër të Shoqatës “Bijtë e Shqipes”, të Filadelfias në SHBA-së, ju sjell përshëndetjet miqësore e vëllazërore për nderimin që i bëni sot birit të shquar të Novosejtë të Lumës, të paharruarit, “Nderi i Kombit” dhe “Heroi i Popullit”, Gjeneral Lejtnant Rrahman Parllaku, në 105 vjetorin e ditëlindjes së tij.

Gjeneral Rrahman Parllaku, është padyshim krenari kombëtare shqiptare, por para së gjithash ai është krenaria e familjes, efisit tonë, e fshatit Novosej ku lindi dhe e Kukësit që e burrëroi, e fisnikëroi dhe e brumosi me shqiptarizëm. Ishin këto virtyte që e karakterizuan në drejtimin e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe në krijimin e konsolidimin e ushtrisë Shqiptare.

Por ne krenohemi edhe me qëndrimin e paepur përballë diktaturës që e burgosi dhe e dënoi padrejtësisht, ndërsa Ai nuk u ligështua, por doli edhe më stoik e udhërrëfyes në mbështetje të proceseve demokratike. Ai u bë dhe mbeti burim frymëzimi edhe për brezat e ardhshëm, përfshi edhe shoqatën tonë “Bijtë e Shqipes”. Në disa aktivitete që ne organizojmë, “Gjeneralin mendjendritur vazhdimisht e kujtojmë dhe e vlerësojmë, siç ai e meriton.

FLAMUR NOKA – Sekretar i Përgjithshëm i PD

Gjeneral Parllaku na “flet” edhe pas vdekjes

Gjeneral Parllaku ishte dhe mbeti deri në fund të jetës së tij një luftëtar. Jeta e gjeneral Parllakut na flet edhe pas vdekjes. Na jep shenja me rezistencën, me forcën, me dinjitetin dhe me burrërinë që na mungon, për të cilën sot flitet pak.

Historia e Shqipërisë, e thujse 100 viteve të fundit, na paraqitet edhe në profilin e tij si burrë, si luftëtar, si ushtarak dhe si politikan.

Te vite, te rrudhat, te betejat e gjeneralit, dukej sikur flisnin disa nga ngjarjet e rëndësishme të Shqipërisë që nga vitet ’30 e këtej.

Ka pasur e ka një debat që vazhdon në Shqipëri për Luftën Antifashiste, apo luftën civile, por nuk mendoj se mund të ketë ndonjë debat për luftëtarët, për lirinë e Shqipërisë dhe qëllimin, pikërisht në atë moment që ata e bënë luftën.

Ideali i tyre, kauza e tyre, perspektiva e tyre, ishte një Shqipëri e lirë.

Rrahman Parllaku është pjesë e asaj plejade të rinjsh, dhe më vonë burrash, që bënë luftën e tyre, por edhe të fshatit, qytetit, krahinës, Shqipërisë dhe të vetë kombit shqiptar.

Në këtë luftë, Parllaku dhe sivëllezërit e tij imagjinuan një Shqipëri të lirë, një Shqipëri të drejtë, një Shqipëri nënë të të gjithëve.

Lufta e tyre duhet ndarë nga paqja që erdhi më vonë, dhe që nuk prodhoi paqe për të gjithë, por një luftë tjetër, edhe më të egër, edhe më vëllavrasëse, të shqiptarit mbi shqiptarin.

Rishkrimi i historisë pa këtë mendim, pa këtë dijeni, është një gabim që thekson luftën në paqe dhe anashkalon luftën që u bë për të sjell paqen dhe lirinë.

Rrahman Parllaku është bashkëfshatari im, por është njëkohësisht edhe



Si një nga të afërmit e tij, si pjestar i fisit emërndritur “PARLLAKU”, ndjehem krenar, sa herë mes shqiptarëve të diasporës përmendet emri i “Gjeneral Rrahman Parllakut”, sepse ai vlerësohet dhe nderohet si Gjenerali-Legjendë në kufirin e tri kohëve, që jetoi e përshkoi, thujse në hapësirën tonë mbarëkombëtare, një rrugë plotë sakrificë, duke reflektuar besë e burrëri, trimëri, mençuri, fisnikëri, humanizëm, atdhetari e shqiptarizëm për të mbetur me grada të përjetshme...si gjenerali që me jetën dhe veprën e tij ka fituar pavdekësinë.

I përjetshëm qoftë kujtimi i tij!




bashkëluftëtari im, bashkëluftëtari ynë, i të gjithë atyre që bëjnë betejë për një Shqipëri të brezave, jo të vetes dhe të grupit të vet.

Si të tillë e nderojmë sot, si bashkluftëtar të të gjithë atyre që luftojnë jo për interesa personale, por për kauzën e përbashkët.

Lufta të cilën ndajmë me gjeneral Parllakun është ajo për një Shqipëri më të mirë, më të drejtë; jo si betejë për të pamundësuar paqen, por që të sigurohet paqja për të gjithë, si opsioni i vetëm për të cilin shkohet në luftë.

105 VJETORI ILINDJES

GJENERAL PARLLAKU NJË JETË PLOT DINJITET NË SHËRBIM TË KOMBIT



SHPENDI TOPOLLAJ

Po të nisesh nga vlerat e larta njerëzore, si mençuria, urtësia, thjeshtësia, trimëria, vullneti, dashamirësia, ndershmëria, por sidomos nga dashuria për Atdhe, aftësitë komanduese, takti në marrëdhëniet me vartësit, pjekuria në marrjen e vendimeve, qartësia në të kuptuarit e situatave politike, stoicizmi dhe burrëria në përballimin e ndëshkimeve të pamerituara, mungesa e plotë e ndjenjës së hakmarrjes, apeli për bashkim mes shqiptarëve, duke mos harruar këtu edhe portretin e tij aq të hijshëm, si model i racës tonë të bukur e krenare, do të thoshja pa frikë se jeta dhe vepra e Heroit të Popullit, gjeneral Rrahman Parllakut, do t'i bënte nder penës së paqortueshme të Plutarkut. Kushdo që e ka njohur atë, apo ka luftuar e punuar krah tij, e di mirë se atij do t'i shkonin si pakujt fjalët e përfaqësuesit të shkollës filozofike të procesit, Alfred North Ēhitehead se "Kuraja e vërtetë nuk qëndronte te forca brutale e heronjve vulgar, por vendosmëria sypatrembur e virtutit dhe arsyes".

Rrahman Parllaku me virtyt dhe arsye iu bashkua rezistencës antifashiste dhe mbeti, si kur ngjiti majat e karrierës partiake dhe ushtarake, ashtu edhe deri në fund të jetës mbi një shekulllo, ai Gega syëmbël për të cilin më fliste gjithmonë nëna dhe gjyshja ime të cilat i kishin shpëtuar jetën në Vlorë, dhe ai u ishte mirënjohës, gjë që e pashë edhe vetë kur shërbeva si oficer i ri në vartësinë e tij si në FUD ashtu edhe në Korpusin e Katërt që ai drejtonte së bashku me të paharruarin Vaskë Gjino. Rrahman Parllaku në kuptimin metaforik ishte shtegu ilustrues nga kaloi historia e Luftës tonë të lavdishme Nacional - Çlirimtare dhe rritja e modernizmi i ushtrisë tonë të pasçlirimt. Fakti që vlonjatët të cilëve kurrë nuk u kanë munguar luftëtarët trima, e zgjedhën pikërisht atë, djalin nga Novoseja e Kukësit, për të drejtuar njësitet guerile, flet shumë. Ai ishte rritur e pjekur në aksione të guximshme e demonstrata kundër pushtuesve, deri tek ajo e lirimit të 43 të burgosurve ditën e 30 vjetorit të Pavarësisë. Por edhe ngjitja galopante, pra besimi në aftësitë dhe talentin e tij për kryerjen e detyrave të rëndësishme në drejtimin e formacioneve të mëdha partizane që po krijoheshin, nga ana e Shtabit dhe Koman-



dës së Përgjithshme, është gjithashtu një tregues i cilësive të rralla të tij.

Rrahman Parllaku, me pseudonimin Krajli, ende djalë i ri, nuk ishte arsimuar si duhet, dhe sidomos nuk kishte njohuritë e domosdoshme ushtarake, por zgjuarsia, vendosmëria dhe intuïta e shpunë drejt suksesve me efektivat në të gjitha luftimet e zhvilluara, duke nisur qysh nga koha kur u emërua komisar batalioni në Br. e V - të S, ku forcat partizane përballuan gjithë egërsinë e Operacionit armik të Dimrit 1943 - 1944. Më tej pasuan detyrat si zv. Komisar i grupit të Vlorës, i Brigadës së VIII - S të dislokuar në Zonën e Parë Operative, komisar i Br. XII - të S. I zgjedhur delegat në Kongresin e Përmetit, Rrahmani, ndërkohë i njohur gjërësisht, takon nga afër thujtë të gjithë udhëheqësit e Luftës, duke filluar nga Enver Hoxha, Spiro Moisiu, Nako Spiru, Koçi Xoxe, Sejfulla Malëshova, Omer Nishani, Ymer Dishnica etj. Tani Rrahmani ishte një kuadër me përvojë e reputacion që kishte dhënë prova të qarta si drejtues i zoti, ndaj dërgohet me Brigadën e tij, ku që zv. komisar, së bashku me Brigadën e V - të, të marrshonin drejt Kosovës, për të ndihmuar në çlirimin e saj. Kosova ka qënë përherë ëndrra e gjeneral Rrahmanit dhe ai vetë përshkruan me mall e dashuri në kujtimet e tij, mikpritjen dhe gatishmërinë për sakrificat të popullit të atjeshëm, ku prisnin me gëzim bashkimin përfundimtar me Shqipërinë. Pas

kryerjes së detyrës si komisar Divizioni, dhe i pranuar si kandidat i K.Q.P. Rrahman Parllaku në majin e 1945 emërohet komisar i Korparmatsës së II - të, në Berat, ku komandant ishte Tahir Kadareja. Kryen gjithashtu detyrat si Drejtor i Personelit në M. Mbrojtjes dhe më pas si Drejtor Politik i Ushtrisë dhe dërgohet për studime në Akademinë emërmadhe "Voroshilov" në Moskë, ku bashkë me shokët thyejnë dyshimin e komandantit të saj, gjeneral leitnantit Kutuzov, se do e kishin të vështirë, pasi nuk kishin arsimin e duhur. Këtu Rrahmani, i zgjedhur anëtar i K.Q. kryente dhe detyrën e atasheut ushtarak në B.S. dhe ata ja dolën ta kryenin mesë miri Akademinë. Pas kthimit në Atdhe, Rrahmanit, të graduar gjeneral në 10 korrik 1952, i ngarkohet detyra e zv. Ministrit të Mbrojtjes dhe drejtorit të Prapavijave dhe më tej ajo e drejtorit të Organizim - Mobilizimit.

Dihet qëndrimi burrëror i tij dhe kolegëve të tij në kohën e daljes nga Traktati i Varshavës, por pasi kreu me nder detyra të tjera si komandant dhe komisar i F.U.D e Korpusit të Katërt, dhe drejtues kryesor në Ministri, erdhën pasojat e atyre konfabulacioneve paranojake të Enver Hoxhës që shkoi në plumb, mbylli në burgje, internoi shumicën e drejtuesve të Luftës Nacional - Çlirimtare, pa kursyer edhe familjet dhe të afërmit e tyre. Ju i keni të freskëta ato ngjarje, ku gjeneral Rrahmani vuajti gjatë në Alcatrazin shqiptar të Burrelit, ku nga torturat kishin vdekur disa nga shokët

e tij, dikur udhëheqësa të asaj lufte heroike dhe ku e ruajti si gjithmonë të paprekur karakterin e malësorit besnik ndaj vendit të vet, për çka mjafton të lexosh letrën akuzë të datës 18 Janar 1988 që i drejtonte ish kolegut të tij Ramiz Alisë dhe ku thotë: "...nuk do të hesht edhe në të ardhmen, edhe sikur pasojat të rëndohen edhe më shumë mbi mua, mbasi edhe në këtë rast mendoj se bëj një punë të mirë për popullin dhe vendin tim". Ne, mijra kuadro të ushtrisë që kemi dalë nga bangat e shkollës ushtarake "Skënderbej" e kemi ndërë nga afër kujdesin atëror që tregonte gjeneral Parllaku me ne. Ai kishte mbetur po ai komisar i dikurshëm i sheshit të Teqesë së Sukës, që nuk donte t'i dërgonte në vijën e parë partizanët ende fëmijë. Por mbi të gjitha, ai mbeti në kujtesën tonë, kuadri i papërkullor e dinjitoz që kur ministri i Mbrojtjes e këshilloi pa të keq, me rastin e marrjes së detyrës së zv. Ministrit, të ndryshonte sjelljen dhe të tregojë më i rreptë, ju përgjigj: "Nuk mund ta ndërroj karakterin sa herë të ndërroj detyrën, por të keni besim se pa bërtitur do ta plotësoj detyrën".

Dhe Rrahman Parllakut i mjaftonin vlerat e larta dhe të papërsëritshme njerëzore, që i kishte aq harmonike, të cilat sepse më kujtojnë atë thënien e Virgjilit se "Virtyti është më i çmuar nëse shkëlqen në një trup të bukur". Dhe ai shkëlqeu se ishte i bukur si nga trupi, si nga shpirti.

KUMTESA



Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

Rrahman Parllaku vend nderi në lëvizjen antifashiste në Vlorë



Heroi Rrahman Parllaku zë një vend nderi në lëvizjen antifashiste në Vlorë, ndaj e vlerësoj këtë përkujtimore që bëhet në nder të 105 vjetorit të lindjes së Tij. Vlerësimi i nderuar për rrugën luftarake të antifashistit malësor “Krajli” në veprimtarinë e njësitit gueril të Vlorës është bërë me vite, por përkujtimi dhe mos harresa e lartësojnë figurën e atentatorëve në këtë vit të 80 vjetorit të çlirimit të Atdheut.

Zërin e Atdheut për të luftuar pushtuesit Rrahman Parllaku e ndjeu si mjaft shqiptar, por i ndodhur në qytetin e flamurit, pasi kushtet e kishin detyruar familjarisht të punonte në trevën e Vlorës, u frymëzua prej idealit të ri që po merrte rinia, frymën antifashiste. Si shqiptar patriot kapi mauzerin dhe rrugicave të Vlorës dhe rrugëve të fshatrave u rreshtua dinjitoz për të luftuar me trimëri, në ballë të bashkëlufetarëve, në njësitet guerile dhe formacionet partizane që po përgatiteshin për kryengritjen e madhe.

Nderin dhe lavdinë këtij trimi dhe kësaj familje patriotike kuksiane nuk jua ka dhënë emri apo farefisi. Në Novosel të Lumës familjen Parrllaku, në shekuj, dje në luftë dhe sot në demokraci gjendet mes një kategorie njerëzish ku aspekti cilësor i tyre konfirmohet te burrëria, karakteri luftarak, pjekuria dhe drejtësia si tipari i tyre më i dukshëm, të shfaqur gjatë gjithë historisë. Kjo “vlerë nderi”, ka qenë një kushtrim luftarak në çdo periudhë të historisë, por në luftën partizane shkëlqeu dhe bëri që tërë Luma e Labëria, nën shembullin e tij, të qepen pas komunistëve e partizanëve, luftëtarëve të lirisë, si blea në hoje. Të gjitha këto cilësi i manifestoi anëtarë i njësiteve guerile të Vlorës, malësori stoik, që u vu në ballë të luftës me idealin e atdhetarizmit, sepse për mision kishin lirinë e Atdheut.

Lumjanët në shekuj kanë dhuruar jetën për mbrojtjen e truallit. Në këtë dhurim jete ka diçka mistike në respektimin e një zemërgjerësie të treguar prej tyre në breza. Ngaqë e donin Shqipërinë jo vetëm të çliruar nga okupatori, por dhe të lirë shpirtërisht, lufta e tyre na çon larg, tek Mahmut Dac Kalisi, Islam Saphiu, Ramadan Zaskovi, etj., tek traditat e etërve të tyre të parë, tek zakoni i lirisë së fisit, tek kaçakët dhe të çetave patriotike e luftëtare.

Rrahmani si çdo antifashist dhe i frymëzuar nga qëllimi final për çlirimin e vendit nga pushtuesit, bashkë me vlonjatët u vu në shërbim të luftës. Duke punuar për bukën e gojës dhe jetuar mes tyre u njoh me bujarinë e mikpritjen, por edhe me guximin dhe vendosmërinë e tyre, për t'u shkruar me tërë

familjen për lirinë e popullit dhe të atdheut.

Në Luftën Antifashiste për çlirimin e popullit shqiptar, si formë organizative të forcave të armatosura, në dhjetor 1941, nisën të formoheshin njësitet e para guerile në qytetet kryesore të vendit me udhëzimin e PKSH-së. Njësitet guerile në qytet u krijuan dhe vepruan paralel me çetat partizane në zona dhe krahina të ndryshme të vendit. Me fillimin e vitit 1942 në mjaft qytete kryesore të Shqipërisë nisën veprimtarinë luftarake njësitet guerile, ku dhe përqëndrimi i pushtuesit ishte më i madh. Njësitet gurile u bënë shkollat e para të luftës, ku u mësua dhe u perfeksionua arti i të luftuarit. Jetën antifashiste Rahman Parllaku e nisi nga njerëzit e varfër të lagjes Llonxha, sot lagjia “Partizani”, nga nënë Tarika Hoxha, për të vijuar me një armatë të tërë partizanë e kuadro, që nën drejtimin e PKSH ju përveshën luftës kundër fashizmit në çdo cep të tokës së pushtuar. Njësitet guerile ishin shumë të thjeshta dhe me pak anëtarë dhe drejtoreshin në shumë raste nga sekretari i celulës. Anëtarët e njësitit gueril ju kërkoheshin edukatë, bindje, disiplinë, konspiracion, largim nga të gjitha vezet, sjellje në familje, në shoqëri, besim të shoku dhe partia për çdo sakrificë.

Në fillim të muajt janar 1942 Raman Parllaku ishte anëtar i grupit edukativ në njësitin e drejtuar nga Arif Hasko, ku bënë pjesë dhe komunistët Et'hem Gjinnushi, Banush Goxha, Vehbi Hoxha, si dhe Koço Kllapi dhe Faik Lamçe. Njësitit bënte aksione të kombinuara dhe me pjesëmarrjen e komunistëve dhe të anëtarëve të grupit edukativ, të rinjve komunist etj. anëtarët e njësitit gueril ishin 80% punëtorë në sektorët ndryshëm në qytet dhe një pjesë e vogël studentë e nëpunës të vegjël.

Në aksione dhe veprime goditës në qytet aktivizoheshin dhe shumë të rinj, anëtarë të grupeve edukative. Në aksione merrte pjesë një masë shumë e madhe e popullit, në ruajtjen, strehimin dhe fshehjen e tyre në kohën e aksioneve. Njësitet guerile drejtoreshin për çështje ushtarake nga anëtarë i Qarkorit i ngarkuar për çështjet ushtarake, si

dhe nga sekretari politik i qarkut.

Aksionet e para të njësitit gueril ku bënte pjesë dhe antifashisti Rrahman Parllaku ishin marrje dhe grumbullimi i armëve, municioneve, mjeteve për nevojën e teknikës, shpërndarja e trakteve, vrasja e spionëve etj. Ai ishte në krye të aksioneve të guximshme që janë zhvilluar në qytetin e Vlorës dhe në rrethinat e saj. Në muajin shkurt 1942 njësitit gueril ku anëtar ishte dhe Rahman Parllaku kreu aksionin në ndërtesën e Gjyqit, ku mori armë, pushkë, rolover dhe municion. Po në këtë muaj nga njësitit u azgjësua tradhëtari që vrau Koçi Bakon në Korçë, të cilin e kishte prurë në Vlorë për ta ruajtur, por bashkëveprimi i njësiteve bëri të mundur neutralizimin e tij. Në muajin prill 1942 u bë atentati kundër një spiunit italian dhe në maj kundër një spiuni shqiptar.

Në prill 1942 njësitit gueril nxorri nga burgu i Vlorës komunistin Fejzo Gjome-ma dhe në muajin maj 1942 nga dhoma e Tregëtisë në Vlorë u morën makinat e shkrimit, i cili pati një jehonë të madhe në popull. Ishte Rrahman Parllaku që në fshat afër qytetit të Vlorës punoi komunikatën e qarkorit të partisë të 21 qershorit 1942 për të “mos shkuar ushtar dhe milicë në shërbim të armikut, për të mos dorëzuar bereqetin dhe asgjë tjetër...”.

Këtë veprim shërbyen si hapat e para për organizimin e luftës së armatosur...

Nga paranvera e vitit 1942 dhe gjatë gjithë vitit 1942 si rezultat i punës në të gjitha fshatrat filluan të krijoheshin njësitet të armatosur fshatare me ushtarë të popullit, të cilat përbëheshin nga 5-7 veta. Këto njësitet shërbyen si baza për krijimin e çetave e formacioneve më të mëdha partizane, të cilat ishin burim i pashteruar për të shtuar radhët e ushtrisë partizane.

Grupet edukative dhe të simpatizantëve u bënë baza e krijimit të njësiteve të armatosura në fshat dhe krahina si në Mesaplik, Dukat...Gjorm, Brataj, Ramicë, Tërbaç, Tragjas, Gumenicë, Mavrovë, Vajzë, Karbunar, Vuno etj.

Në këtë kohë tregëtimi i armëve bëhej me shkëmbim në natyrë... municion e shisnin dhe ushtarët italianë...tregëtimi

i armëve pati rëndësi të madhe se u armatos populli, tregoi patriotizmin për luftë kundër pushtuesit. Me porosi të Qarkorit u krijuan qendrat e grumbullimit të armëve, depo të armëve...u armatosën pjesëtarët e njësiteve të para guerile dhe ilegalët e parë që dualën nga qyteti...

Suksesi i aksioneve pati ndikim të madh politik dhe psikologjik në masat e popullit. Taktika partizane e veprimit me grupe të vogla, të befasishme dhe në vende dominonjëse ishte forma më frutdhënëse që u zhvillua gjatë 4 aksioneve të mëdha që u zhvilluan në vitin 1942, eksperiencia ishte e paktë... kështu u gërshetuan aksionet në terrene më të mëdha si në Qafën e Pëllumbit, në vrasjen e Tenentes në Vuno, në Dorëz, në prerjen e linjave telefonike... në qendrat e milicisë dhe karabinerisë etj. Antifashistit Rrahman ndjeu dhimbje kur ju “vranë shokë luftëtarë trima, si Teli Ndini, 4 heronjtë e lagjes Topana, Shyqyri Alimerko e Sadik Zotaj etj”.

Gjatë vitit 1943 Rrahman Parllaku kreu me dinjitet detyrën e vështirë por të lavdishme të komandantit të njësiteve guerile të qytetit të Vlorës dhe më 28 nëntor 1943, mori detyrën e komisarit të batalionit në BrVS.

Mundi, gjaku dhe sakrificat e tyre janë të gdhendura dhe të skalitura në gjoksin e nënë Shqipëri. Të gjithë partizanët, heronjtë e dëshmorët, por dhe veteranët e kësaj lufte vezullojnë, pavarësisht se kohët që po jetojmë dhe njerëzit e rrymave të ndryshme duan t'i harrojnë, përsëri gjenden zemra shqiptare që i përkujtojnë dhe nderojnë me madhësi, si ky përkujtim në 105 vjetorin e lindjes të njërit nga komandantët e suksesshëm të njësiteve guerile në qytetin e Vlorës, por dhe luftëtarit e kuadrit të Luftës së Dytë Botërore të zhvilluar në Shqipëri.

Ende Vlorë dhe Shqipëria kanë shumë për të bërë për këta heronj, që brezave do t'u ngelen amanet për sakrificat dhe gjakun e derdhur në luftë për liri. Jeta dhe vepra e tij duhet të jetë simbol i dukshëm i një atdhetarie të flaktë në monumente, në libra, në vepra arti, në këngë e në tërë diapazonin e një përjetësimi të madhërishtë.

REFERATI

Publicistika impresionuese e gjeneral Rrahman Parllakut

Kujtesë historike për të kaluarën, thirrje për të tashmen

Nga Sakip Cami

Fisi im shtrihet në të dy anët e Drinit të Zi, edhe aty ku ky lumë, nga më të dashurit për shqiptarët shërben si kufi shtetëror. Pra edhe unë e kam ndjerë mbi supe, çdo të thotë ndarje, çdo të thotë repressio, çdo të thotë mall. Prindërit e mi i panë njerëzit e tyre të gjakut në Dibër të Madhe dhe në viset e tjera të Kosovës dhe të Maqedonisë vetëm pas 45 vjetësh, vetëm pas vitit 1991. Kosova e lirë ka qenë ëndrra e të gjithë shqiptarëve. Me gjeneralin, këtë bir të Lumës dhe të Kosovës më lidh jo vetëm qenia ushtarak, por edhe fakti se babai im ka qenë bashkëluftëtar me të në rreshtat e ushtrisë antifashiste Nacionalçlirimtare dhe që kanë luftuar për çlirimin e Kosovës në vitin 1944.

Atë që nuk e arritëm në vitin 1944, e arritëm 55 vjet më vonë në vitin 1999. Fati e solli që gjeneral Rrahman Parllaku dhe disa të tjerë të ishin përsëri protagonistë të çlirimit të Kosovës, protagonist të çlirimit përfundimtar. Dhe protagonist mbetet protagonist.

Në faqen 78 të këtij libri është një fotografi shumë domethënëse. Në foto është gjeneral Rrahman Parllaku me disa gjeneralë të tjerë të Luftës Nacionalçlirimtare e të ushtrisë shqiptare, që të shoqëruar nga koloneli Sali Onuzi në vitin 1999 vizitojnë Kukësin dhe frontin verilindor. U emocionova shumë nga kjo foto dhe nga këto fakte kuptimplotë sepse unë në atë kohë kam punuar si gazetar ushtarak në gazetën e Ministrisë së Mbrojtjes "Ushtria" dhe e kemi botuar këtë fotografi.

Gjeneralët e vjetër por me shpirt të ri dhe zemër të madhe nuk shkuan si vizitorë në Kukës e Morinë. Gjeneral Rrahmani ishte rritur në këto anë. Ata i thërriste zëri i atdheut, zëri i vëllezërve tanë kosovarë që luftonin në UÇK dhe që kishin sado pak nevojë për përvojën e madhe të këtyre ushtarakëve të lartë. Ata u pritën nga biri tjetër i Lumës, komandanti i Divizionit të Kukësit Gjeneral Kudus Lama, që koha jo rastësisht e thirri në skenë në këtë kohë dhe në këtë vend.

Në atë kohë gazeta "Ushtria" pa përfilluar politikën shtetërore hapej me titujt bomastikë "Plagoset Ram Buja", "Tym dhe flakë në Grykën e Morinit" etj. Por edhe ministri i mbrojtjes së asaj kohe Luan Hajdaraga e kishte zhvendosur stafin e tij dhe të shtabit të përgjithshëm në Kukës dhe në Tropojë.

Pra nëpërmjet fakteve dhe dokumentave, artikujve, letrave, komenteve, takimeve dhe vizitave, gjeneral Rrahman Parllaku tregon se Kosova ka qenë dhe mbetet pjesa më vitale e trupit të shqiptarëve. Atë që nuk arritëm ta mbanim dhe ta bashkonim më 1945, tani e fituam dhe nuk e lëshojmë më, aq më tepër kur miqtë ndërkombëtarë si SHBA dhe të Europës na ndihmojnë dhe i kemi përkrah. Por edhe Zoti i madh, Perëndia, thotë ndihmo vehten të të ndihmoj unë. Pra faktori vendimtar kanë qenë dhe janë shqiptarët, të cilët për hir të së vërtetës po punojnë mirë dhe që duhet të punojnë akoma më mirë, më të bashkuar dhe më me mençuri. Libri i Gjeneral Rrahman Parllakut është një memorie historike për të kaluarën, është një thirrje për të tashmen, për të mos lëshuar asnjë pëllëmbë territor, për të gëzuar fitoren e lirisë, por edhe për të administruar me kujdes fitoren dhe për të mos u dehur nga arritjet. Ne ushtarakët e dimë fort mirë se çdo të thotë të lëshosh territor. Po lëshove një majë dije se ke lëshuar një fushë



të tërë më pas.

Pjesa e parë për kontributin e kosovarëve në Luftën e II Botërore dhe për çlirimin e Jugosllavisë, e divizioneve shqiptare për çlirimin e Kosovës dhe të viseve të tjera në Jugosllavi ka një rëndësi të veçantë sepse shkruhet nga një gjeneral, nga një luftëtar konkret, dhe godet teorinë famëkeqe të serbve se kosovarët kanë qenë në anën e pushtuesve gjermanë. Ashtu sikurse kundërshtarët tanë nuk lodhen së shkruari kundër nesh ashtu edhe ne nuk duhet të pushojmë së shkruari e të argumentuari me fakte e dokumente se jemi ne ata që e kemi bërë këtë vend, se jemi ne të parët dhe më pas le të vinë të dytët e të tretët.

Ne nuk jemi racistë dhe nuk ngasim njeri, por u marrim gjak në vetull kujtdo që na prek në nder dhe dinjitet.

Autori jep me emra se kush kanë qenë drejtuesit e formacioneve partizane, si u zhvillua lufta, të rënë dhe të plagosurit. Pra është një dokument shtesë në historinë e lavdishme të shqiptarëve. Pas daljes nga burgu komunist, ndonëse i lodhur dhe i dërmuar nga vitet e gjata të errësirës Gjeneral Parllaku nuk pushoi së punuari për Shqipërinë dhe Kosovën. Ai u vu në krye të Organizatës së Veteranëve të Luftës Nacionalçlirimtare, botoi me dhjetra deklarata për shtyp, artikuj dhe material në gazetën "Veterani", "Rilindja Demokratike" "Standard" "Sot" etj në mbrojtje të devizës së shqiptarëve dhe të bashkimit të tyre.

Jo rastësisht ai përveç se kryetari OBVL është edhe një nga 9 anëtarët e Këshillit Kordinues të organizatave jo qeveritare në ndihmë të Kosovës. Kudo ku përrurohet një lapidar, ku shkruhet dhe folet për një hero apo dëshmor të UÇK, ku diskutohen fatet e shqiptarëve është gjeneral Rrahman Parllaku. Në këtë libër publicistik nuk duhet të presim klas të lartë të stilit publicistik, megjithëse edhe ky nuk mund mungon, por ky libër është protestë, është këngë lirie dhe këngë gjaku, është memorie historike, është dëshmi që duhet ta dijë dhe ta ketë çdo shqiptar i Shqipërisë dhe i Kosovës.

Pas një shekulli ata që e shkakton këtë padrejtësi në përcaktimin e kufijve filluan të reflektojnë dhe të koregjojnë gabimet e tyre. Le të shpresojmë në koregjimin e plotë dhe në bashkimin e plotë të të gjithë shqiptarëve.

Ndërsa Gjeneral Rrahman Parllaku si një epilog testament e mbyll kopertinën e këtij libri me shënimin: "Arrita realizimin e një prej ëndrrave të mia të kahershme, pavarësinë e Kosovës. Kisha luftuar për çlirimin e saj. Kisha marrë edhe plagë në trup, por atëhere nuk u fitua liria. Po e shoh sot atë (Kosovën) të lirë, të pavarur, tek kapërcen vështirësitë dhe pengesat dhe ecën e sigurtë dre-

jt konsolidimit të pavarësisë, drejt zhvillimit dhe përparimit të saj. Kërkesë tjetër dhe aspiratë e shqiptarëve ka qenë dhe mbetet bashkimi ynë kombëtar. Jam i bindur se edhe kjo ëndërr e imja do të bëhet realitet. Unë jam i moshuar dhe mund të mos ja mbërrij kësaj dite, por jam i sigurtë se vijat kufitare të hedhura në harta, nuk mund të mbajnë përjetësisht të ndarë popullin e një gjuhe dhe gjaku që aspiron bashkimin. Uroj që kjo të ndodhë sa më parë!

Prof. Dr. Jusuf Bajraktari, drejtor i Institutit të Historisë në Prishtinë që ka shkruar edhe parathënien e këtij libri në referatin e tij kryesor thekson se Z. Rrahman Parllaku është një emër i veçantë dhe personalitet që të krijon afërsinë dhe ndjenjën e respektit për figurën e tij si dhe për ngjarjet, fenomenet dhe personazhet që i zë në gojë gjatë bisedave spontane.

Rrahman Parllaku, duke qenë njëra nga figurat më të shquara të Lëvizjes Antifashiste Nacionalçlirimtare në Shqipëri, i cili, përkundër moshës, ka një kujtesë e kondicion të lakmueshëm dhe zë një vend të veçantë në kujtesën tonë historike. Kujtimet e tij për Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare janë një kontribut i çmuar. Mori pjesë në luftën për çlirimin Kosovës nga fashistët si komandant i Divizionit V Sulmues.

Në këto kujtime, autori paraqet të dhëna me interes të posaçëm për kontributin e dëshmuar dhe përpjekjet e të gjitha forcave shqiptare që luftuan kundër pushtuesve në kuadër të Aleancës Antifashiste. Në pjesën e kujtimeve gjatë luftës në Kosovë, Gjeneral Parllaku do të sjellë kujtimet e tij nga takimi me vëllezërit Hasan e Gani Kryeziu, në fshatin Devë të Gjakovës. Ai përpigjet t'i sjellë shprehjet e këtyre bisedave ashtu si i ka ruajtur në kujtesën e vet për plot 62 vjet.

Rrahman Parllaku na jep kujtimet në mënyrën origjinale, duke u ndalur në momente më të rëndësishme dhe duke i interpretuar me mjeshtri të rrallë përjetimet e tij gjatë luftës në Kosovë si: Lufta e Junikut, qëndrimi në Mitrovicë, takimi me Miladin Popoviçin dhe oficerët rusë. Ai njëherazi ruan me besnikëri frymën, idetë, porositë origjinale dhe prezantimin e rrethanave të kohës, ndër më delikatët gjatë luftës.

Në kapitullin e dytë z. Parllaku ndalet në krijimin e Divizionit të V-të si dhe sukseset e këtij divizioni drejt marshimit të përgjithshëm në Mitrovicë, Rashkë, Pazar i Ri si dhe gatishmërinë për të zhvilluar mësymjen në drejtimin Sjenice-Priepole. Duhet cekur se autori vlerëson lart forcat e Divizionit të V-të, të cilat ai i komandonte, si përfaqësues të denjë të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, qëndrimin e tyre shembullor me popullin vendas, veçanërisht në terrenin e banuar me serbë e malazez.



Libra të botuar:

1. *Mirënjohje familjeve vlonjate që më mbajtën si birin e tyre, 2007.* - Me parathënie nga Prof. Muharrem Dzhigju;
2. *Kosova, andrra e jetës sime, 2011,* - me parathënie nga Prof Jusuf Bajraktari, drejtor i Institutit të historisë së Kosovës;
3. *Një shekull në memorie, botim i UET, 2019,* - me parathënie nga Dr. Hajri Mandri
4. *20 Vjet OBVL, nën drejtimin e Gjen. Rrahman Parllakut, kryetar i OBVL dhe përgatitur për botim dhe redaktuar nga Halil Rama dhe Sakip Cami, viti 2014;*
5. *"Një legjendë në kufirin e dy kohëve" monografi kushtuar Heroit të Popullit dhe Nderit të Kombit Rrahman Parllaku përgatitur nga Halil Rama dhe Sakip Cami - me parathënie nga Teodor Laco, 2014;*
6. *"Gjenerali që sfidoi kohërat", monografi e përmirësuar dhe e shtuar kushtuar Gjen. Rrahman Parllakut në 100 vjetorin e tij nga Halil Rama dhe Sakip Cami, 2019 - me parathënie nga Prof. Paskal Milo;*
7. *Kujtime për shokët, libër në dorëshkrim -- botuar pjesë pjesë në shtyp, kushtuar shokëve të luftës, shokëve të ushtrisë, shokëve të burgut dhe shokëve të demokracisë e të organizatës së veteranëve.*

Autori, siç është e kuptueshme, vihet në mbrojtje të të vërtetave historike, për veprimet luftarake të forcave që ai i udhëhoqte në Kosovë, si për luftimet e brigadave të 3-të e të 5-të për çlirimin e Rrafshit të Dukagjinit, (Prizrenit, Gjakovës e Pejës me rrethinat e tyre), si dhe u kundërvihet të pavërtetave që janë shkruar për veprimet e Divizionit të 5-të e të 6-të pas kthimit në Kosovë, në mes të marsit 1945, me përfundimin e luftimeve në Sanxhak, Mal te Zi dhe Bosnjë.

(Vijon në faqen 9)

IN MEMORIAM

I PËRJETSHËM KUJTIMI I PËRPARIM HYSENIT

*Pimi ishte njeri i mirë, i dashur e parimor; mishëronte dhe përçonte kudo me zgjuarsinë e tij natyrore vlerat më të mira njerëzore, urtësinë dhe mençurinë karakteristike dibrane... Pimi ecte shpejt, punonte shpejt, jetonte shpejt, arrinte synimet shpejt, dhe mesaduket e plotësoi edhe misionin e tij shpejt. Ndaj dhe iku shpejt!
I përjetshëm qoftë kujtimi i tij. I ndritët shpirti në parajsën e përjetshme!*



Si edhe para një viti, moderatorit Defrim Methasani – Mjeshtër i Madh, i kërkohet të mbajë një fjalë rasti, por nuk e ka të lehtë, sepse i duhet të flasë për një nga miqtë e tij të veçantë..., për një njeri shumë të dashur të familjes Hyseni.

Sepse Pimi, iku duke na lënë kujtime që na zgjojnë ndjenja të freskëta dashurie dhe admirimi për të.

Ai pati një jetë të vullshme, plot sakrificë. Kudo që ai punoi, në vendlindjen e tij në Reçin – kryemal të Nandë Maleve historike të Dibrës, në Tiranë dhe si emigrant në Itali e Gjermani, me ndershmërinë, njerëzinë dhe respektin e tij bëri miq dhe shokë të shumtë. Po. Pimi ishte njeri i mirë, i dashur e parimor; mishëronte dhe përçonte kudo me zgjuarsinë e tij natyrore vlerat më të mira njerëzore, urtësinë dhe mençurinë karakteristike dibrane.

Në fakt ai e tregoi vehten si biri i denjë i babait të tij, Arifit, i cili që nga moshë e tij e re dhe deri sot në këtë moshë të thyer, ka trashëguar e lartësuar virtutet më të mira të të parëve të tij, të njohur për qëndresën heroike kundër pushtuesve turq, serbë e nazifashistë, për besë e burrëri. Edhe në këtë përkuajtore Ai mbahet si burrë zakoni, i paepur e me karakter të fortë. “Fjala e Defrimit, por edhe të gjithë Ju miqtë e shumë që më gjendeni pranë, më duket sikur ma ringjallni Pimin”, thotë i përbotur Arifi. Babai Arifi, nëna Fatmirja, vëllezërit Mirushi e Mani; motrat Fidania, Shukrija e Lulja, hallat Fatimja, Hanja e Xharija, nipërit e mbesat; miqtë e shokët e tij të shumtë nga e gjithë Shqipëria, ndonëse jetojnë me kujtimet e PIMIT të paharruar, ndjehen pafundësisht mirënjohës ndaj të gjithë atyre që i nderuan me praninë në këtë përkuajtore.

Dhe kanë të drejtë, se kështu PIMI mbetet i gjallë në memorien e tyre. Pimi ecte shpejt, punonte shpejt, jetonte shpejt, arrinte synimet shpejt, dhe mesaduket e plotësoi edhe misionin e tij shpejt.

Ndaj dhe iku shpejt!

I përjetshëm qoftë kujtimi i tij. I ndritët shpirti në parajsën e përjetshme!

Halil RAMA – Mjeshtër i Madh

Edhe një vit pas ndarjes nga jeta në moshën 45 vjeçare, Përparim Hyseni (PIMI) “mblodhi” në takimin përkuajtor më 21 prill 2024, aq shumë njerëz (familjarë, të afërm, miq e shokë) sa një vit më parë, kur e përcollën për në botën e përtejme...

Ndonëse ditë me shi, karvani i autoveturave për te varrezat publike të Kamzës nuk kishte të sosur. Të gjithë ata që e kanë njohur bënë homazhe në nderim të këtij djaloshi, portreti i buzëqeshur i të cilin në fasadën e mermertë të varrit të tij, duket sikur ju thotë: “Ja, jam sërish mes jush!”.

Gjithsesi, të gjithë përloteni.

Lotë përmallimi nga babai Arifi, nëna Fatmire, xhaxhai Avdiu, daja Xhemë Toshi..., nga vëllezërit Mirushi e Mani; motrat Fidania, Shukrija dhe Lulja..., por dhe nga Mjeshtri i Madh Muharrem Gjoka (burri i hallës së tij) që e deshi aq shumë, si birin e nipin e tij. Lotët na rrjedhin çurkë edhe ne miqve të tij, mua e Defrim Methasani, ndërsa nipërit Luftun, Edin e Gentin (sidhe disa nipër tjerë të Familjes së nderuar Hyseni) mezi i largojmë për t’ua liruar vendin të tjerëve që të bëjnë homazhe.

Sa shumë njerëz edhe në drekën përkuajtore!!!

Kujtesë historike për të kaluarën, thirrje për të tashmen

(Vijon nga faqja 8)

Në pjesën e publicistikës na jep mënyrën origjinale të të menduarit prej një patrioti të kulluar, duke u ndalur në momentet më të rëndësishme të shqiptarëve të Kosovës, të Maqedonisë si dhe të Luginës së Preshevës. Për Gjeneralin Parllaku preokupimi kryesor është përpjekja për të shpjeguar rrethanat e shtypjes, të dhunës e të gjenocidit të egër ndaj vëllezërve shqiptarë që jetonin në viset e tyre në ish-Federatën Jugosllave.

Në përfundim mund të konstatojmë se ky libër përbën një dëshmi për personalitetin e Gjeneral Lejtënant Rrahman Parllaku dhe brezat e tij.

Vehap Shita, Sekretar i Shoqatës të Veteranëve të LANÇI të Kosovës, shkrimtar në fjalën e tij ka thënë se libri më i ri i Gjeneral Lejtënant Rrahman Parllakut “KOSOVA E LIRË, ëndrra e jetës sime” është shkruar me njohuri prej ushtaraku e me plot emocione e dashuri të sinqertë prej një patrioti të preokupuar me fatin e vendit e të popullit të tij me “ëndrrën e jetës” së tij që Kosovën njëherë ta shohë të lirë e të bashkuar me trungun vet, nënën Shqipëri. Këtë, jo vetëm që e ëndërronte autori, por për këtë edhe luftoi me tërë qenien e tij si drejtues partizan, si gjeneral e strateg në momentet kur vendi dhe populli i tij duhej të pozicionohej drejt që, në ato momente vendimtare të Luftës së Dytë Botërore, të mos gjendej në anën e humbësve, siç ka ndodhur shpesh gjatë historisë.

Në arkiva ka shumë dokumenta që e lartësojnë veprën e guximin e tij. Libri i Gjeneral Rrahman Parllakut është një memorie historike për të kaluarën, është një thirrje për të tashmen, për të mos lëshuar asnjë pëllëmbë territor, për të gëzuar fitoren e lirisë, por edhe për të administruar me kujdes fitoren dhe për të mos u dehur nga arritjet. Autori jep me emra se kush kanë qenë drejtuesit e formacioneve partizane, si u zhvillua lufta, të rënë dhe të plagosurit. Pra është një dokument shtesë në historinë e lavdishme të shqiptarëve.

Pas daljes nga burgu komunist,

ndonëse i lodhur dhe i dërmuar nga vitet e gjata të errësirës Gjeneral Parllaku nuk pushoi së punuari për Shqipërinë dhe Kosovën. Ai u vu në krye të Organizatës së Veteranëve të Luftës Nacional çlirimtare, botoi me dhjetra deklarata për shtyp, artikuj dhe material në gazetën “Veterani”, “Rilindja Demokratike” “Standard” “Sot” etj në mbrojtje të devizës së shqiptarëve dhe të bashkimit të tyre.

Jo rastësisht ai përveç se kryetari OBVL është edhe një nga 9 anëtarët e Këshillit Kordinues të organizatave jo qeveritare në ndihmë të Kosovës. Kudo ku përurohet një lapidar, ku shkruhet dhe folet për një hero apo dëshmor të UÇK, ku diskutohen fatet e shqiptarëve është general Rrahman Parllaku. Në këtë libër publicistik nuk duhet të presim klas të lartë të stilit publicistik, megjithë edhe ky nuk mungon, por ky libër është protestë, është këngë lirie dhe këngë gjaku, është memorie historike, është dëshmi që duhet ta dijë dhe ta ketë çdo shqiptar i Shqipërisë dhe i Kosovës.

Gjeneral Rrahman Parllaku si një epilog testament e mbyll kopertinën e këtij libri me shënimin: “Arrita realizimin e një prej ëndrrave të mia të kahershme, pavarësinë e Kosovës. Kisha luftuar për çlirimin e saj. Kisha marrë edhe plagë në trup, por atëhere nuk u fitua liria.

Po e shoh sot atë (Kosovën) të lirë, të pavarur, tek kapërcen vështirësitë dhe pengesat dhe ecën e sigurtë drejt konsolidimit të pavarësisë, drejt zhvillimit dhe përparimit të saj. Kërkesë tjetër dhe aspiratë e shqiptarëve ka qenë dhe mbetet bashkimi ynë kombëtar.

Jam i bindur se edhe kjo ëndërr e imja do të bëhet realitet. Uroj që kjo të ndodhë sa më parë!

Gjenerali Rrahman Parllaku nëpërmjet publicistikës së tij u jep përgjigje shumë pikpyetjeve, paqartësive dhe sasive të qëllimshme si ato për masakrën e Tivarit, a ishte lufta antifashiste luftë civile, roli i divizioneve shqiptare në Ish Jugosllavi për shkaputjen e kosovarëve nga divizionet gjermane, për shkrimin e historisë nga historianët profesionistë dhe ata ushtarakë etj.

PËR MASAKRËN E TIVARIT

Masakra e Tivarit është një sagesë e Uran Butkës. Uran Butka gënjen atje. Uran Butka hodhi një parullë që ka qenë Ramiz Alia. U bë fakt sikur Ramiz Alia ka organizuar Tivarin. Unë dhe Ramizi, kur ndodhi ngjarja e Tivarit kemi qenë në Mitrovicë të Kosovës. U kthym në 15 mars në Mitrovicë nga Sanxhaku. Tivari ka ndodhur në 12 ose 13 prill, nuk e mbaj mend mirë. Kur unë po vija nga Sanxhaku mezi po sillja të plagosurit. U mobilizua të shëronim të plagosurit dhe të sëmurët. Ata i vranë serbët, brigade e dhjetë malazeze.

Për masakrën e Tivarit ka shkruar një libër Uran Butka. Sipas librit, faji për Tivarin, më ngarkohet mua dhe Ramiz Alisë. Sikur ne i kemi rekrutuar, i kemi organizuar dhe i kemi nisur ata njerëz në Tivar. Një absurditet dhe një shpifje pa asnjë bazë. Këtë pjesë, unë e kam sqaruar kur është promovuar libri i Uran Butkës në Tivar. Unë isha i ftuar nga komisioni për organizimin e këtij promovimi dhe me ftesë direkt të Mehmet Bardhit, ish-deputet i shqiptarëve në Maqedoni. Si qëndron e vërteta? Më lartë thashë se ne jemi kthyer në Kosovë më 15 mars të '45-ës. Kurse të pushkatuarit e Tivarit, nga tri kolona, janë nisur nga datat 22-26 mars në drejtim të Kukësit dhe Shkodrës për në Tivar. Pra, 8 ditë pasi jemi kthyer në Kosovë. Bëhet pyetja: A kishim ne si komandë divizionin mundësi që të komandonim pushtetin ushtarak që ishte vendosur në Kosovë pas ngjarjeve të Drenicës? A bëhet lajmërimi në të gjitha degët ushtarake të Kosovës dhe a bëhet organizimi dhe grumbullimi në Prizren i kolonave nga Mitrovica, Podujeva, Peja e Gjilani brenda 8 ditëve? Qoftë edhe sikur të kisha helikopter-in në dispozicion, të kisha telefonin e sotëm për të lajmëruar? Kur lidhja atëherë brigadat, ose kur i komandoja, kjo gjë bëhej vetëm me korrierë pasi nuk kisha telefon. Dhe duke i marrë parasysh të gjitha, a arrihen këto të bëhen më këmbë me korrierë nga Sanxhaku e Bosnja? Vetë ky akt tregoi absurditetin. Koha është e dokumentuar, për ti nisur këto kolona nga Prizreni në Tivar, ishte e pamun-

duar.

Unë e kam mësuar këtë ngjarje vetëm kur shkova sekretar politik i qarkorit të Shkodrës. Uran Butka është mbështetur për këtë sagesë në një raport që na bënte brigada vartëse e jona nga Skënderaj e Drenicës. Këto raporte i ka marrë sikur na bëhej nga Tivari. Edhe ky është një absurditet, sepse që të vinte korrieri nga Tivari në Drenicë ku ishim ne, duhej një javë që të vinte korrieri. Duhej në javë që të kalonte alpet. Sepse e përsëris, ne nuk kemi pasur telefona e mjetet tjera të sofistikuara komunikimi.

Ekzekutimi është bërë nga brigada e X malazeze, me urdhër të Peko Dapçeviq dhe Mila Gjilasë që komandonin korparmatën jugosllave. Për këtë ngjarje është bërë gjyq për komandën e brigadës së X në Jugosllavi.

PËR RISHKRIMIN E HISTORISË

Historia që është shkruar në kohën e diktaturës, është histori e politizuar. Dhe përpjekjet e tanishme për të rishkruar historinë, sërish nuk i kanë shpëtuar politizimeve në kahje të ndryshme.

Nuk është ndarë historia e LANÇ nga diktatura, nga periudha e saj.

Lufta është e lavdishme, se është bërë nga djem dhe vajza nga 13 vjeç deri në 22, 25 vjeç, që kanë demonstruar sakrificë mbinjerëzore.

Ajo luftë solli çlirimin e atdheut dhe bashkimin e Shqipërisë me aleancën antifashiste të popujve të udhëhequr nga Anglia, SHBA dhe Bashkimin Sovjetik. Historia nuk bëhet me historianë politikane.

Historia duhet shkruar me historianë të faktuar nga Akademia e Shkencave dhe që janë historianë jo të partive. Nga një anë, kur flitet për luftën, flitet me madhësi dhe nga ana tjetër, përpiqen të mohojnë vlerat e saj. Historia duhet të thotë të vërtetën. Edhe tani që është krijuar një komision për rishkrimin e historisë për shkollat, prapë është krijuar nga qeveria dhe jo nga Akademia e Shkencave, e cila duhet të jetë timoni i drejtimit të shkrimit të

(Vijon në faqen 11)

REPORTAZH

TESTAMENTI I ATDHEDASHURISË...

• *Shqiptarët ndihen krenarë me jetën dhe veprën e “Heroit të Popullit” dhe “Nderit të Kombit” Rrahman Parllaku, që bëri gjithçka në shërbim të atdheut e kombit. Prandaj, edhe vlerësimet dhe nderimet ndaj veprës së gjeneralit janë plotësisht të merituar*

Halil RAMA – Mjeshtër i Madh

Me 17 prill 2024, familja, të afërmit dhe miqtë tij të shumtë, përkujtuan gjeneralin legjendë në kufirin e tri kohëve, Rrahman Parllaku - Hero i Popullit dhe Nderi i Kombit, në 105-vjetorin e ditëlindjes së tij. Pesë vjet më parë, kur sapo kishte mbushur një shekull jetë, atij ju festua me madhësi ditëlindja jubilarë shekullore me disa veprimtari të larmishme. E meritonte, sepse Ai vinte në kapërcyellin e shekullit të jetës së tij, me profilin e burrështetasit me bukuri të rrallë fizike e shpirtërore dhe me memorie të freskët, si memoria historike e kombit.

Pesë muaj pas festimit të kësaj ditëlindje, ai iku për në botën e përtejme, duke lënë pas për brezat testamentin e atdhedashurisë.

Me 17 prill 2024, në një Akademi Përkujtimore, që OBVL organizoi në sallën “Aleks Buda” të Akademisë së Shkencave Ai u përkujtua si sfidanti i kohërave.

Ai, sfidoi varfërinë në bjeshkët e Sharrit, sfidoi pushtimin e vendit me armë, shpirt e zemër; luftoi për çlirim e Shqipërisë e të Kosovës, sfidoi diktaturën dhe u la brezave një shembull të madh virtyti dhe idealizmi. Gjenerali që “u fik në paqe dhe iku në këmbë” (siç shprehet gjeneral Piro Ahmetaj), iku duke i lënë familjes, bashkëluftëtarëve e bashkëpunëtorëve, shokëve e miqve në gjithë hapësirën mbarëshqiptare të vetmin testament, atë të atdhedashurisë...

Gjeneral Parllaku ishte ndër të paktët partizanë që jetoi dhe dëshmoi histori të tri kohëve, të organizatorit e drejtuesit të Njësiteve guerile në qytetin e Vlorës, të partizanit e luftëtarit antifashist, heroit e komandantit ushtarak dhe atë të persekutimit komunist. Ai ia doli mbi të gjitha faturnat e jetës, doli fitimtar nga Lufta Antifashiste, doli gjallë nga burgu komunist, doli fitimtar në luftën për pavarësinë e Kosovës dhe deri para pesë vitesh ishte gjenerali më i vjetër, por me mendje të re, që mbështeste anëtarësimin e Shqipërisë dhe të ushtrisë shqiptare në NATO dhe integrimin e saj në BE.

Vetëm para pesë vitesh, me rastin e 100-vjetorit të lindjes, Bashkia e Tiranës e nderoi atë me titullin “Simbol i qytetit të Tiranës” (ndërkohë që në 95-vjetorin e lindjes ish-Presidenti i RSH Bujar Nishati e dekoroi me titullin e lartë “Nderi i Kombit”). Pasi kishte marrë më parë “Qytetar nderi” i komunës së Kuveleshit, “Qytet-



ar nderi” i Bashkisë Shijak, “Mirënjohja” e Këshillit të Qarkut Tiranë dhe “Qytetar nderi” i Qarkut Kukës, Kryebashkiaku i Tiranës Erion Veliaj e vlerësoi Parllakun si një nga figurat emblematike të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, që sfidoi edhe regjimin e diktaturës komuniste, si simbol i gjallë i kujtesës patriotike, qytetare dhe historike. Dhe në të vërtetë, ai qe kthyer në simbol të gjallë të kujtesës patriotike, qytetare dhe historike. (Edhe në moshën 100 vjeçare mban te përmendësh vargjet e poemës “Lahuta e Malcis” të Fishtës”).

Kujtesë historike për të kaluarën, thirrje për të tashmen

(Vijon nga faqja 4)

historisë dhe jo mënjanimi i saj nga historia.

Detyrat për çlirim e Kosovës kanë qenë tre kryesoret.

E para, që të ndihmojmë për çlirim e popullit të Kosovës.

E dyta, të godasim dhe të pengojmë forcat e grup-armatës gjermane që tërhiqeshin nga Greqia dhe Maqedonia për në Perëndim.

Dhe e treta, të ndikonim që populli i Kosovës të merrte pjesë në LANÇ.

Kjo për faktin se deri atëherë, Kosova njihej si përkrahëse e divizionit SS Skënderbej, në regjimentin Kosova dhe reparte të tjera, që ishin të lidhur me okupatorët gjermanë.

Qëllimi ishte që, Kosova të kalonte në bllokun antifashist, për të pasur të drejtën e vetëvendosjes pas çlirimit.

Luftimet në Kosovë kanë qenë të rrepta. Kemi pasur 42 dëshmorë dhe 64 të plagosur si brigadë.

Me çlirim e Kosovës, më 28 nëntor, kam marrë urdhrin e krijimit të divizionit të V, ku u caktova komandant i divizionit dhe u gradova nënkolonel.

Në përbërjen e divizionit ka qënë, brigada e III, e V dhe e XXV.

Në përbërje të divizionit erdhën gjithashtu dhe 1600 kosovarë. Ishin ata që na kishin luftuar në duke mbrojtur tërheqjen e gjermanëve. Por, megjithatë, ne i kemi trajtuar si të gjithë partizanët e tjerë. Erdhën partizanë te ne dhe kanë luftuar për çlirim e Sanxhakut dhe Bosnjës Jugore.

Në shtypin e Kosovës dhe tonin, ka pasur lajme

sikur divizionet tona kanë vrarë në Kosovë dhe kanë bërë krime, gjë që nuk i përgjigjet të vërtetës.

Këtu do ju jap një shembull. Në luftimet që drejtova unë në Kosovë, mu vranë në Junik të Pejës, 32 veta dhe u plagosa edhe vetë. Përpos kësaj, shumë pjesëtarë të divizionit SS Skënderbej rob dhe nuk pushkatuam asnjë.

Për fatin tim, në 60-vjetorin për fitoren mbi nazi-fashizmin, në Teatrin e Prishtinës, ku isha i ftuar të flisja për këtë ngjarje, përmenda këtë akuzë dhe thashë: “A do ketë ndonjë të gjallë që ta kujtoj? U ngrit ndonjë nga fundi dhe tha: Jam unë. U vërtetua pas 60 vjetësh që ne nuk kemi vrarë kosovarë, por, kemi luftuar për Kosovën.

A ISHTE LANÇ LUFTË CIVILE ?

Edhe për këtë problem unë kam folur në emisionin “Opinion” të Blendi Fevziut, përballë autorit të librit Uran Butka. Në emision ka qenë i ftuar gjithashtu, Sabri Godo, Pëllumb Xhufi dhe Urani.

E kam shpjeguar që nuk mund të ketë luftë civile kur ke okupatorin brenda. Nuk bëhet lufta mes dy partive të një vendi për pushtet. Lufta u bë kundër okupatorit për çlirim e vendit dhe në kohe luftë të tillë luftohen edhe ata që janë në krah të okupatorit. Shembullin e luftës civile e kemi tek fqinjët tonë grekë, ku u bë luftë civile pasi ikën gjermanët nga Greqia. A kanë pasur qëllim pushtetin ata që kanë drejtuar luftën? Patjetër. Sepse ata që luftojnë, duan të jenë edhe në krye të vendit. Por kjo nuk e bënë luftën e popullit, luftë civile.

Shqiptarët ndihen krenarë me jetën dhe veprën e “Heroit të Popullit” dhe “Nderit të Kombit”, që bëri gjithçka në shërbim të atdheut e kombit. Prandaj, edhe vlerësimet dhe nderimet ndaj veprës së gjeneralit janë plotësisht të merituar.

Me gjeneral Parllakun, ndihemi krenarë të gjithë. Ai ishte dhe mbetet përmendore e gjallë e traditës dhe e virtytit familjar të trashëguar ndër shekuj.

Opinionin publik ka mirëpritur edhe librat e ndryshëm të shkruar nga gjenerali, siç është ai me titull: “Mirënjohje familjeve vlonjate që më mbajtën si birin e tyre”, “Kosova, ëndrra e jetës sime”, dhe librin me shtatë kapituj në 466 faqe “Një shekull në memorie”.

Me një kujtesë të jashtëzakonshme, me një mendjemprehtësi të madhe, gjeneral Parllaku ka bërë analiza brilante të situatave të vështira e delikate që ka kaluar vendi dhe ushtria jonë. E veçanta e gjithë “ligjëratave” të tij në shtypin e kohës dhe në veprimtari promovuese të librave kushtuar Luftës Nacionalçlirimtare e heronjve të saj, ka qenë gjykimi i tij tepër i saktë, konciz, realist, pa mllafe, pa paragjykimë... Ai e ka vlerësuar gjithnjë lart Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, arritjet dhe përpjekjet e popullit jo vetëm në rindërtimin e Shqipërisë së pasluftës, por edhe ato në fushën e arsimit, shërbimit shëndetësor, zhvillimit në tërësi të vendit, përfshirë edhe arritjet në mbrojtjen e fuqizimin e ushtrisë...si dhe këto vite të demokracisë e pluralizmit.

NGA JETA E KËTIJ MATUZALEMI NA ULET KËMBËKRYQ HISTORIA

Nga jeta e këtij Matuzalemi na ulet këmbëkryq historia. Nga lufta dhe përkushtimi i tij atdhetar na vjen një model për t'u ndjekur... Nga veprimtaria e gjeneral Parllakut si veteran në këto tri dekada të demokracisë mund të mësojmë se kurrë nuk është vonë për njeriun që të bëhet mbështetës aktiv i proceseve demokratizuese të shoqërisë.

Në spiralet e historisë, gjeneral Parllaku ka ditur të lakohet me dinjitet, duke pasur si kolonë bazë përkushtimin kombëtar shqiptar dhe progresin shoqëror, si thelb i motivimit që gëlonte shpirtin e tij progresist e liridashës. Vështirë të përmbledhësh në pak radhë, në kuintesencë, motivimin e personalitetit të tij, zhvillimin konjitiv e psikomotor të këtij djaloshi që ngjitej nga Novosej i Kukësit në Tribuna të larta shtetërore, në hero të popullit të tij, në drejtues madhor ushtarak, duke ndryshuar variablat në kontekste politike në funksion të mbijetesës dhe qëndresës, nga udhëheqës i shquar në të dënuar me burg, nga triumfator në grigjë të rrezikut për jetën, nga piedestali i kuadrut të dobishëm në stigmën e “njeriut të rrezikshëm”, ekstreme këto që provokuan në personalitetin e tij, qëndrime dhe vlera të larta politiko-shoqërore në raportin e ndjenjave të forta estetike midis dashurisë dhe urrejtjes. Këtë volum ideor dhe estetik e përcolli përgjatë shekullit të jetës së tij, një burrë shtetar, një organizëm vital, një mendje koherente dhe një vizion largpamës dhe perspektiv.

HEROI QË FITOI DUKE MERITUAR LAVDINË DHE PAVDEKËSINË

Retrospektiva dhe perspektiva kanë një prerje të artë në personalitetin e gjeneral Parllakut. Atë e përkushon frymëzimi dhe dashuria për atdheun e tij, si lajtmotiv vijues mbikohor, që çliron në rrethana tipike energji shpirtërore pozitive në luftën e jetës. Jeta e tij është një shembëlltyrë e rrallë që na fton të kuptojmë se jeta meriton të jetohet kur luftohet fort dhe fitohet. Si një ushtarak, korrekt, i shquar, ai mbështetej në skrupuj të fortë të moralit kombëtar, me pikëvështrim të qartë dhe të kthjellët, duke ngjitur një nga një shkallët e karrierës ushtarake, si një gigand hijerëndë që ngjitet i sigurt në bedenat e kalasë.

Kalaja e pushteteve në kohë të ndryshme dhe situata të ndryshme, pati edhe shembje morale e poli-

(Vijon në faqja 11)

REFLEKSIONE



Gjeneral Parllaku, H. Rama e N. Sudar. Në Konferencën e veteranëve të Ballkanit në Zhabjak – Mali i Zi – 2016.

GJENERAL RRAHMAN PARLLAKU, FIGURË EMBLEMATIKE E SHQIPËRISË...

Nga **NIKOLLA SUDAR**

Historian dhe përkthyes

& "Mjeshtër i Madh"

Është nder dhe privilegj të kesh njohur nga afër luftëtarin më të shquar të kohës, antifashistin e orëve të para dhe demokartin e flaktë, birin e lavdishëm të Shqipërisë, të paharruarin në shekuj, Rrahman Parllaku.

Më 15 shtator 2019, pikërisht para pesë vjetve, u nda nga jeta, në Tiranë, në moshën 100-vjeçare, personaliteti më popullor i Shqipërisë së sotme, "Nderi i Kombit, "Heroi i Popullit", kryetari i OBVL-s, Gjenerali legjendar, RRAHMAN PARLLAKU.

Unë kam pasur nderin dhe privilegjin e veçantë ta shoqëroj gjeneralin si përkthyes në dy takime shumë të rëndësishme të veteranëve të Ballkanit: më 2016, në Zhabjak (të Malit të Zi), bashkë me sekretarin e Përgjithshëm të OBVL-s, z. Halil Rama dhe më 2018, në Beograd (Serbi), bashkë me të bijën, z. Tatjana Parllaku.

Gjenerali-legjendë në kufirin e dy kohëve, që para tetë dekadave drejtoi

Divizionin e V Sulmues të Ushtrisë shqiptare, në luftën për çlirimin e viseve të të Kosovës, me atë pathosin e luftëtarit të papërkulur antifashist, theksoi me forcë rolin dhe detyrat e veteranëve në luftën kundër terrorizmit. Fjala e kryetarit të delegacionit shqiptar, legjendës së gjallë të këtij vendi, gjeneralit të pamposhtur 98-vjeçar, Rrahman Parllaku, këtij kolosi fisnik, mbajtur në Konferencën Ballkanike të veteranëve, në Zhabjak të Malit të Zi, (në korrik të vitit 2016), që fitoi menjëherë admirimin e të gjithëve të pranishmëve, u prit me interes të jashtëzakonshëm. "Ndihej i privilegjuar dhe me fat, - theksoi Ai, - që në moshën 98-vjeçare më jepet rasti të flas për angazhimin tonë në luftën pa kompromis kundër terrorizmit botëror. Ashtu si para 72 vitesh, pasi kishim çliruar Shqipërinë me forcat tona, në kuadrin e Aleancës Antifashiste të Popujve, në krye të Divizionit të V-të dhamë kontributin tonë për çlirimin e Kosovës, Bosnjës e Sanxhakut, ndërsa Divizioni VI luftoi edhe në Mal të Zi dhe sot ne, veteranët e LANÇ të popullit shqiptar mbështesim pa rezerva luftën kundër këtij armiku,

të rrezikshëm, po aq sa edhe fashizmi", - theksoi gjeneral Parllaku. Ai vlerësoi angazhimin e qeverisë shqiptare në koalicionin botëror kundër terrorizmit, në kuadrin e NATO-s. "Ashtu, si para shtatë dekadash u rreshtuam përkrah forcave progresiste të Perëndimit edhe sot ne jemi më të vendosur se kurrë për të përmbushur angazhimet dhe detyrimet tona në këtë Aleancë", - shtoi ndër të tjera kreu i OBVL të popullit shqiptar. Jeta dhe kontributi i gjeneralit Rrahman Parllaku në historinë e Shqipërisë, përgjithmonë do të mbeten shembull i madh i një atdhetari të vërtetë dhe i një humanisti të paharruar. Mbase tingëllon si guxim i tepruar, por thjesht si historian, si qytetar i këtij vendi, po shfaq mendimin tim modest:

"Vallë, a nuk ka ardhur koha që në pedestalin e burrave të shquar të këtij vendi, krahas Skenderbeut, Ismail Qemalit, Isa Buletinit, Bajram Currit, Fan Nolit, të zërë vendin e merituar edhe gjenerali legjendar Rrahman Parllaku? A nuk do të ishte vlerërim i merituar, sikur t'i ngrihet një përmendore në Tiranë dhe një inistitucioni të rëndësishëm t'i vihet emri i tij?"



RRAHMAN PARLLAKU DRITË E LIRISË

Nga **MEVLUD BUCI**

Ma tha zemra, kujtoj Runjën,
Ma tha shpirti krejt konaku,
Ma tha koha kujto ballëfurtunën
Po ku je Rrahman Parllaku?!

Mos harroni kurrë qëndresën
Ka le shqipe toka arbnore,
Mos harroni dritën dhe besën,
Gjeneralin rritur në llogore.

Kush është dritë, dritë e lirisë,
Kush asht lis bash si bajraku,
General bir i shqiptarisë
Nder i Kombit Rrahman Parllaku.

Nder i Kombit Rrahman Parllaku
Shtatin rrit nëpër beteja,
Lum Arbnia për bir konaku
Uragan për kohëra të reja.

Uragan e qëndresëtar,
Uragan me shpirt kristali,
Toka ty të ka thesar
Rrahman Parllaku gjenerali.

U nisa e pashë Gjalllicën
Bedenat në tokën kuksiane,
Atje mora këngën-dritën
Për këtë trim bir tramundane.

Ju përfala Korabit, Drinit,
Iu përfala Ilirisë,
Iu përfala kryetrimin
Peallak trimit, prijës të ushtrisë.

E thonë malet shkrepë e gurra
E thonë lisat dhe konaku,
Hero i Popullit, burrë mbi burra
Gjeneral Rrahman Parllaku.

Ku të kam o shpirt hyjnor,
O legjendë e Nanë Arbnisë,
O shpirtmirë të thërret llogori
Për etninë e shqiptarisë.

Për etninë e shqiptarisë
Tokë e Arbërit vadit nga gjaku,
O kryetrim në ballë të ushtrisë
O i shtrenjti Rrahman Parllaku.

Fol Kosovë, fol shqiptari,
Ke lind burra lis bajraku,
Për atdhe e për nder t'Arbnisë,
Ndrin në breza Rrahman Parllaku.

Ndrin në breza Rrahman Parllaku
Ndrin kjo tokë, tokë e Arbnisë,
Tokë e vaditur me lumenj gjaku
Rrahman Parllaku dritë e lirisë....

TESTAMENTI I ATDHEDASHURISË...

(Vijon nga faqja 10)

tike, por këto nuk e dobësuan dhe përlulën gjeneral Rrahman Parllakun, këtë soj të fortë shqiptari, që me mençuri diti të manovrojë në spiralet e rrezikshme të historisë shqiptare.

Heroi i luftës në terren, i luftës dhe përbaljes në gjyqë ushtarake, përballoi burgie e privime dhe fitoi duke merituar lavdinë dhe pavdekësinë. Jeta iu afrua Heroit herë me tufa me lule, herë duke u derdhur mbi të me tërë egërsinë e saj. Rrallë gjen shembuj të tillë të personalitetit, ku të jenë ngjizur e plazmuar në mënyrë

aq mjeshtërore vetitë e karakterit të një intelektual patriot, të një drejtuesi e komanduesi të aftë ushtarak, të zgjuar dhe trim, të thjeshtë dhe të ndershmë, të bukur në trup, shpirt dhe mendime. Ai ishte një model i ardhur nga genocidi komunist si dëshmitar i gjallë për të kuptuar dhe vërtetuar peripecitë dhe traumat që kaloi ky popull i orientuar dhe i ideologjizuar gabimisht nga rryma dhe korrente të huaja. Mbi 20 vjet në krye të Organizatës të bashkuar të Veteranëve të Luftës, me ndershmëri dhe principe të larta morale, ka kontribuar në ndriçimin e mjaft skenave dhe protagonistëve, të vërtetave dhe kërkimeve historike, duke dhënë edhe

në moshë pensioni, një ndihmesë të vyer në emancipimin politiko-shoqëror e demokratik të shoqërisë. Si një lundëtar i shquar, ai e drejtoi varkën e shpëtimit duke kapërcyer me sukses tallazet e historisë deri në brigjet e paqta të demokracisë që po jetojmë. Jo vetëm gjatësia kohore e jetës, por dendësia dhe përmbushja e saj me veprime, qëndrime dhe vlera në përmbajtjen e saj, e bën këtë figurë të lartësoshet në nderimin tonë shoqëror, ku zëri dhe mesazhet e tij dëgjohen deri në organizata famoze ndërkombëtare. Në këtë vështrim, gjeneral Rrahman Parllaku përbën një shembull frymëzimi për atdhedashurinë dhe përkushtimin qytetar.

HISTORIA

Me rastin e 110 vjetorit të Kuvendit lab të Shtëpëzimit

KUVENDI I SHTËPËZIMIT BESË E SHPRESË PËR SHQIPËRINË

(Në nderim të kapedanëve të këtij Kuvendi Selam Musa Salaria, Halil Huto Sullo, Sulo Beqiri (Sulo Beqir Bedaj), Mersin Gjoça, Sali Murat Vranishti, Çerçiz Ago Topulli, Bajram Ligu (Prongjia), Hasan Xhiku, etj. Pjesëmarrjes në këtë kuvend të kapitenit hollandez De Val (De Éaal), lejtanti Juljus Sonne, ekipit mjekësor hollandez të përbërë nga mjekët ushtarakë Tido Reddinguis dhe Van Vliet si dhe civili De Groot. Në mirënjohje edhe për atdhetarin Manxhar Taka që ka shkruar para një dekade librin "Drithërimat e Katërmëdhjetës" që hedh dritë mbi egërsinë e qeveritarëve dhe ushtrisë greke që ishin vërsulur 110 vite më parë kryesisht kundër popullsisë muslimane shqiptare të Labërisë, ku vullnetarët patriotë e atdhetarë të Labërisë e më gjerë jo vetëm që kundërshtuan burërisht pushtimin dhe makinacionet asimiluese, por u thanë "ndal" barbarive greke në Shqipërinë jugore. Nderim burrave që shkruan histori me trimëri, mençuri dhe vendosmëri si dhe nderim në përjetësi gjakut të të rënëve!).

Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

Shtëpëzi është një copëz e historisë kombëtare shqiptare. 110 vjet më parë më 10 prill 1914, malet e Labërisë kishin hequr qelshen e bardhë të dëborës. Në këmbët e tyre jeta rrjedhte "e qetë", por e shqetësuar që në zhargonin popullor është quajtur "drithërimat e katërmëdhjetës". Gjithë fshatrave të jugut dhe mbarë Labërisë i kanosej një prej gjëmave më të tmerrshme të shekujve. Qeveria e Ismail Qemal Vlorës ja kishte besuar kontrollin e vendit Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit (KNK). Vilhelm Vidi kishte disa ditë që kishte zbaritur në Durrës dhe "sundonte" në një zonë të papërfillshme në Durrës. Vendi ishte rrethuar me dhelëpëri nga "uqër" të të gjitha ngjyrave. Gjarpërinjtë e kombit shqiptar ishin ngritur për të copëtuar trupin e një Shqipërie londineze ende pa unitetin e duhur. Jugut dhe veriut të vendit i ishte veshur ushtritë mercenare të lakmive të megalidhësë dhe të naçertanjes të planifikuar në skutat më të errëta të barbarisë ballkanike. Në Gjirokastrë "shqiptari" famëkeq Zografos kishte ngritur një qeveri që trembej vetëm nga kapedanët e Labërisë. Dhe këta kapedanë fole e kishin në zonat më luftarake, ku në magje bashkë me bukën gatuhej liria, liria që rrugën e niste në odat dhe në kuvendet e Labërisë, atje ku lidhej besa dhe niste veprimi luftarak i kryengritjes së përgjithshme popullore. Në këto kushte ogurzeza për Shqipërinë e shqiptarët për t'i thënë "ndal" dorës kriminale pushtuese nga Jugu në Shtëpëzin historik, kemi një eveniment memorial për Labërinë, për Shqipërinë dhe për mbarë kombin shqiptar, që në gjuhën historiografike është i njohur si Kuvendi i besëlidhjes popullore të Shtëpëzimit. Është kjo arsyeja që ndryshe këtij kuvendi i thonë: "Besa e Labërisë në Shtëpëz", që ishte besë e shpresë për Shqipërinë.

KAPEDANËT E LABËRISË NË SHTËPËZIN HISTORIK

Fshatrat, njerëzit dhe kapedanët e Labërisë ishin të gjithë gjerdan në kuvende. Kjo u vërtetua edhe në njoftimin gojë më gojë në gjithë Labërinë e më gjerë: "Kapedanët në takim në Shtëpëz, për t'i bërë ballë hasmit që ka ardhur tek dera. Thirrjes ju përgjigjen të gjithë prijësat e çetave. Të gjithë shkuan në Shtëpëz në kuvendin historik të prillit 1914. Kapedanët lidhën besën për luftë ndaj andartëve. Ka kaluar 110 vjet dhe Shtëpëzi është po ai, mes gjelbërimit me kokën "pështetur" në faqe të malit dhe që ngjason me bedenat e një kalaje të stërlashtë. Edhe pse ka humbur gjallërinë ende ka vellon jeshile të hijeshisë e të qetësisë. Shtëpëzi të fton si në një ballkon ku lugina e Drinos duket në pëllëmbë të dorës, nga Lekëli deri në Kakavijë. Përballë tij qëndron hijerëndë manastiri i Cepos, vendi i Zotave, karakoll mijravjeçar i mbushur me ngjarje heroike, kuvende, ku "shkruhej" e ardhmja e gjithë trevës. Në të djathtë lugina e lumit të Kardhiqit që kullon bardhësi dhe që përfundon me qafën e Skërficës dhe atë të Shtufit. Mali i Gjerë, mali i Lucës dhe mali i Pusit mbyllin horizontin me rryma ajri të freskëta mëngjesore, për t'ia lënë vendin ditës së ndritshme gjithë diell.

SI FISHEKË GJERDANI PËR KOMBIN ARBEROR.

Është fakt se, sa herë binte briri i luftës lebrit, gjirokastritët, lunxhiotët, tepelenasit e përmetarët ishin bashkë, sikurse thotë polifonia, lidhur "si



fishkë gjerdani". Kështu ishin mbledhur edhe në fillim të prillit 1914 paria e kuvendi të kapedanëve dhe prijësve. Nga Fushëbardha Halil Sullo, legjenda e pushkës, burrërisë dhe mendjemprehtësisë së bashku me katër djem fushëbardhas: Dalip Kondi, Surja Tefa, Rizal Muho e Sejdi Baho. Nga Golëmi ishte kordinatori i katër çetave Sulo Beqiri, luftëtar trim dhe i meçur, që me krismën e katër çetave që drejtonte shkroi epope lavdie. Po kështu nga Zhulati Mersin Gjoça kapedan e prijës, figurë shumë e njohur popullore krahinore, por dhe trimi Hazhi Zeman Muxhai. Gjithashtu merrnin pjesë luftëtar kombëtar Çerçiz Topulli, që vinte nga fronti i përjetshëm i luftimeve për liri. Çerçizi kishte shkruar me gjak historinë kur çeta e tij me Hito Labin (Lekdushim) dhe Bajram Ligu (Prongjia) shrinë përtokë bim-bashin osman, troditën themelet osmane me betejën në Mashkullorë dhe kishin mbjellë farën e lirisë ë çdo fsahat. Në Kuvend kishte ardhur dhe trimi e luftëtar i paepur Hasan Xhiku, legjenda e të gjithë luftimeve me osmanët, grekun e italianin e 20-tës. Nga Salaria kishte ardhur Selam Musa Salaria me një pjesë të çetës së tij; nga Vranishti historik ishte kapedan Sali Vranishti, që ka hyrë në histori me këngën "Kapedan Sali Vranishti sa rrojte të punojë gishti..", etj. Prijësa e kapedanë të tjerë shkuan në kuvendin e Shtëpëzimit, ku ishin mbledhur përfaqësitë e gjithë fshatrave të Kurveleshit të sipërm dhe të Kardhiqit si dhe nga luftëtarë të Lunxhërisë si dhe fshatrave të tjera përreth.

PESË HOLLANDEZË NË SHTËPËZ NË KUVENDIN E LABËRISË KUNDËR ANDARTËVE

Kuvendi i Shtëpëzimit ishte vlerësuar dhe nga ekipi holandez që kishte ardhur në Shqipëri për ngritjen e xhandarmërisë ushtarakë shqiptare dhe me bekimin e Fuqive të Mëdha të kohës. Ishte koha kur Fuqitë Europiane ishin "bindur" se edhe Shqipëria duhej të krijonte Shtetin e vet sipas modelit Perëndimor. Gjithësesi kufijtë territorialë shtetërorë do të ishin ata, që u përcaktuan nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër në vitin 1913. Është fakt i njohur historik se gjatë Luftërave Ballkanike 1912 - 1914, e sidomos pas largimit të pashmangshëm të Princit Vilhelm fon Viddi më 3 shtator 1914, por edhe gjatë shtjellimit të ngjarjeve të Luftës së Parë Botërore, Shteti Shqiptar u zhduk: territori i tij u shndërrua në fushëbeteje për fqinjët dhe objekt këmbimi për Fuqitë e Mëdha. Antanta e përdori këtë territor si karrem për të tërhequr në kampin e saj Greqinë, duke i dhënë "linçesën" atë të pushtojë Korçën e Gjirokastrën, sikurse i premtoi Italisë se, do të lejohej të vendosej në portin e Vlorës dhe në ishullin e Saza-

nit. Në takim ishin edhe kapiteni hollandez De Val (De Éaal), lejtanti Juljus Sonne si dhe ekipi mjekësor i përbërë nga ushtarakët Tido Reddinguis, Van Vliet dhe civili De Groot. Takimi i Shtëpëzimit u inicua nga hollandezët mbështetur nga një batalion xhandarmërisë shqiptare. Qëllimi ishte që të vëzhgohej nga afër tërheqja e ushtrisë greke dhe rivendosja e autoritetit të shtetit shqiptar nën drejtimin e Vilhelm Vidit. Në fakt ishte direktiva e Fuqive të mëdha. Ushtria e grekut po tërhiqej nga Picari, Fushëbardha e Kardhiqi. Urdhëri i fuqive të Mëdha ishte që ata të dilnin jashtë kufirit të njohur të "Shqipërisë londineze" të miratuar nga Konferenca e Ambasadorëve. Takimi i Shtëpëzimit ishte përzgjedhur në kohën e vendin e duhur. Shtëpëzi ngjante si një vendkomandë lufte në faqe të malit, që priste e përcillte kapedanë, ku lidhej besa si gjerdan i gatshëm për beteja.

KUVENDI I SHTËPËZIMIT - "BESË PËR LIRINË, BESË PËR SHQIPËRINË"

Labëri, djemtë ti bën guri,/Përuken, veç tek flamuri!

Burrat e bashkuar në idealin e lirisë lidhën besë që do të zinin pikësëpari të pesë shtigjet e Labërisë por shtegu i parë ishte qafa e Skërficës. Ata u bashkuan kundër synimeve të qeverisë autonomiste të Vorioepirit me seli në Gjirokastrë. Oshëtiu zëri i kapedanit e kryeplak i Fushëbardhës Halil Huto Sullo, i cili kërkoi nga hollandezët vetëm armë dhe municion se gjithë burrat e fshatit ishin të gatshëm për luftë. Kishin vetëm pak mauxer, maliher e disa nagantë. Një pjesë e tyre të fshehur në Qafë Dardhë që të mos i gjenin ushtarët andartë të kapitenit grek Xhavarrës (komandant i postës greke në 1913-1914). Këto anë nuk kishin pasur ndonjëherë ndihmë shteti deri në këtë periudhë. Për herë të parë shikonin dhe mjekë hollandezë në Labëri. Personel mjekësor tradicional kanë qenë nënat labe dhe ilaçet popullore si melhem për plagët si dhe shehlerët, hoxhallarët e ca "doktorë" pleq e plaka që mjekonin me mjete rrethanore. Foli Sulo Beqiri, Kapedan Çerçizi, Xhaferi nga Gusmari, Latifi nga Progonati. "Fermani i kuvendit të Shtëpëzimit" ishte i qartë: "...të mbyllet me çdo kusht e me çdo sakërficë Skërfica, kjo portë e moçme e Labërisë nga kapedan Halil Sullo dhe burrat e Fushëbardhës, Zhulati e Rrëzomës, por edhe luftëtarë të tjerë. Kapedan Sulo Beqiri me çetat e tij u vendos nga Manastiri i Cepos, Qafa e Shtufit, Gryka e Kaparielit dhe Rehovës, Jomenin dhe me radhë.. gjithë shtigjet e Kurveleshit dhe të Labërisë". Duke u bazuar në ngjarjet e luftës së vullnetarëve labë kundër ushtrisë greke, në pranverën e vitit 1914, të shkruara bukur edhe në librin e intelektualit Manxhar Taka "Drithërimat e Katërmëdhjetës", ndalimi i mësymjes së andartëve u mundësua më 22 Prill 1914, nga forcat e vendosura të rreth 700 luftëtarëve të Labërisë dhe jo vetëm. Edhe një herë vërtetohej ajo që thoshte ish kryeministri i fqinjëve grekë Eleftherios Kyriakou Venizelos (1864-1936): "Le të ketë një çik Shqipëri, po të mos ketë Labëri". Historia e luftimeve për liri nuk do të rreshtet dhe as do të dorëzohet përballë civilizimit, përbashkimit në institucionet ndërkombëtare dhe as përballë globalizmit. Paskaqenë e shkruar që thënia proverbiale të jetë plotësisht e vërtetë: "Labëri, djemtë ti bën guri,/Përuken, veç tek flamuri!"

DYFEKU-ZANAT I LABIT

Krismat për lirinë përcjellin historinë në një krahinë e treve luftarake të panëdhshtruar ndaj çdo pushtuesi. Ishin këta prijësa dhe çetat e tyre që përbalton akademikët ushtarakë fqinjë, që hodhën në koshin e plehrave të historisë strategjitë e tyre, përfshi edhe ata ushtarakë grekë që kishin studiuar në akademitë gjermane. Kishin kaluar gjithë jetën me armë në dorë. Në Shtëpëz nuk munguan edhe rromuzet, kur oficerët hollandezë kërkonin t'u mësonin lebërve artin e luftës si dhe armët. Ata nuk e dinin se shqiptarët kishin lindur me armë. Lebrit ishin mjeshtra kur merrnin nishan në zemër dhe dinin ti dërgonin plumbat në lule të ballit.

Djalëria e labërisë këpuste edhe fijen e gjalmit me plumb. Dyfekun e kishin zanat. "Mësimi" i armëve në Shtëpëz nga lejtanti Juljus Sonne i njohu me arsenalin e armëve të andartëve grekë që pothuaj ishin që të gjitha i markave bavareze gjermane me pushkë gjysëmautomatike, mitroloza e armë artilerie, topa të kalibrave të lehtë e të mesëm, por dhe thikat që mbanin në brez. Depërtimi në gojëdhënën popullore, në arkivën e përditshme të shqiptarit, por dhe në fondet dokumentare gjejmë ende krismën e betejave popullore të 120 burrave në Fushëbardhë, 60 burrave në Zhulat, 170 luftëtarëve të Golemit, 100 luftëtarëve të Lekëdushit, 80 luftëtarë të Gusmarit, 46 burra të Rexhinit, 110 burra të Nivicës dhe çdo fshati të Labërisë.

NË ROJE TË TOKËS SHQIPTARE

Kuvendi i Shtëpëzimit ishte një odë burrash në ballkonin e luginës së Drinos. Atje lidhej besa për çdo pëllëmbë të tokës shqiptare të kthehej në xhephane lufte, për të shenjtëruar: "ruajtja e tokës shqiptare".

(Vijon ne faqen 14)

KULTURË

Botimi “UDHËTIM NËPËR VISET E DRINIT E TË VARDARIT 1863)

Iballa sipas albanologut të shquar HAHN

Xhemal MEÇI
Studiues & “Mjeshtër i Madh”

Hahn (JOHANN) mbasi arriti në Mertur Gurit, për vështirësi terreni, udhëtimin për në Fierzë vendosi ta bënte në këmbë. “Ne vendosëm, pra, ta vazhdojmë në këmbë udhëtimin tonë buzë Drinit, deri tek Rruga e Madhe nga Shkodra në Prizren, distancë kjo që këtu në përgjithësi llogaritet me katërmbëdhjetë orë, duke ditur që rruga ishte e gjatë. Muhamedani i ri, Mertur, (i cili u kishte dhënë mushkun e tij për deri në Fierzë), na dha me qira deri në Spaç Vaspas, mushkën, etj. Ai ishte nipi i Derven -Agës së Ikballës (Iballe)”. Ky titull (Derven Aga) në të kaluarën kishte qenë i trashëgueshëm dhe mbartësi i tij gëzonte njëkohësisht të drejtën e komandës së përgjithëshme mbi gjithë Dukagjinin.

Personi në fjalë quhej Sulejman Bej. Ai kishte një natyrë dashamirësie dhe të pëlqyeshme. Ai nuk mendohej në anjë mënyrë të nxirrte në pah prejardhjen e tij dhe nuk shquhej në asnjë drejtim, as përsa i takon veshjes dhe as përsa i takon mënyrës të të sjellurit, nga të tjerët, të cilët megjithatë nuk mungonin të shprehin ndaj tij një farë respekti. Në mënyrën e të sjellurit dhe të të menduarit të shqiptarëve, siç ngjet tek të gjithë popujt luftarak të këtij kurrizi, duke ndjekur herë drejtimin jugor dhe herë drejtimin jugperëndimor dhe duke kaluar më tepër nëpër pyje, se sa nëpër vende të çveshura, Sulejman Beu na tregoi në një nga këto vende të çveshura Ikballën (IBALLËN). Këtu ne ndodheshim pothuajse tre çerek ore larg nga Lagja e saj kryesore, dhe ...kjo lugore duhet të ketë një gjërësi nga perëndimi në lindje prej afersisht tre çerek ore dhe një gjatësi nga veriu në jug pak më të gjatë. Ajo konsiderohet si zona më pjellore e gjithë Dukagjonit.

Në një pikë që ndodhet pothuajse në mes të kësaj lugoreje lartsohej një kodrinë e vogël, e cila, parë që këndeje, na pergjasonte me një çerdhe urithash, mbi të cilën ngrihej kulla e hijshme e Sulejman Beut. Kjo, për fat të keq, duke qenë se është meremetuar kohët e fundit, kishte një pamje tepër moderne.

Pranë saj ndodhej xhamia me një minare të vogël. Që atëherë më në perëndim ishte kisha (e Thaçit) dhe rreth e përqark shtëpitë e shpërndara të fshatit. Parë nga këndvështrimi ynë kjo tërësi ishte grupuar në një mënyrë mjaft piktoreske.

Siç shihet HAHN nuk e shpjegon saktë emrin e këtij fshati, por e shqipton si e ndinë prej vendasve - Ikballe. Për mendimin tim ky emër nuk lidhet me një burim të huaj aq më pak turk, Ikballe -Ikballe, por

ALBANESISCHE STUDIEN. STUDIME SHQIPTARE



Johann Georg von Hahn

me një burim vendas arbëror: I + ball. I-ja në të folmën e vendasve ka dhe rolin e njëjës së kallzorës - në. Prandaj gjëndet si në shprehjet : “shkoi i Miliska, i Poravë, i Mzi etj. , në vend që të thuhet: “shkoi në Miliska, në Poravë, në Mzi” etj. Kështu edhe për Iballën , “shkoi në ballë, I +ballë - Iballe”, sepse nga ana perëndimore qëndron mali i lartë për ballë, që është quajtur në vazhdim Bale. Këtë përgjigje i dhashë zv/ ministrit , Prof. Dr Hasan Duma, kur pyeti për emrin e Iballës. Duket se e miratoi në heshtje këtë përgjigje që i dhashë (14 shtator 1974, kur bujti në shtëpinë e Mal Baram Sokolit, ku kishte ardhë për rastin e 70-vjetorit të shkollës Iballe). Besoj se ky shpjegim do të ishte i mjaftueshëm për të dhënë emrin e fshatit Iballe në libër, në botimin e librit “SHKOLLA IBALLËS”...në mos ka një shpjegim tjetër.. Por ky botim do të kishte dalë me më pak mangësi po të kishte autori konsulent studius të mirëfilltë si Dr. Vitor Maluta me gradë shkencore, plus Abdyl Arifin, që të dy ish - nxënës të Shkollës Iballe dhe njohës të mirë të Iballës në çdo vështrim. (E theksoj këtë sepse lexuesi don të ketë të dhënat më kryesore të mjaftueshme historiko-gjeografike e gjuhësore për Iballën. Këtu mangësitë fillojnë që nga titulli i librit, një titull i rëndomtë pa asgjë që lidhet më 120-vjetorin e saj. Ndofta do të ishin më të gjetura vargjet e rapsodit Prendush Gega (Artist i merituar) ... “N’ FUSHË T’ IBALLES DO TË

BAJMË SHKOLLËN/ DO TË BAJMË SHKOLLË/ DO TË BAJMË SARAJ...”. Përkundrazi ky “poet i maleve” (siç e quan Prof. Dr. Ernest Koliqi) për më tepër as që përfshihet gjëkund në këtë libër me mangësi të pranueshme.. Mandej ka interpretime antishkencore si p. sh. Dukagjini i Vjetër.. Asnjë autor serioz nuk e përdor termin Dukagjini i vjetër, aq më pak për Pukën! Le të marrim relatorët me Gjergj Bardhin, Frang Bardhin deri te Hani e Sami Frashëri. Në faqen hyrëse, autori K. Deda fut një citat nga autor anonim për të dalë tek termi i gabur Dukagjini i Vjetër. Sigurisht, do të ishte më mirë, që një citat i tillë të merrej nga dijetari ynë i shquari Sami Frashëri (vell 2, Tiranë, 1988 te DITURIA, kap.XIII, Fq, 76) ku S. Frashëri e ka shprehur aq mirë atë që kërkon autori Kolë Deda për Shkollën: “Në ka gjë për të cilën shqiptarët duhet të kujdesën më tepër ajo pa dyshim është DITURIA... duhet të kenë SHKOLLA...”.

(Për shqarim të më tejshëm për termin e gabuar DUKAGJINI I VJETËR, le të shohim si e trajto HANI Dukagjinin: “ ... Popullsia e Dukagjinit dhe Mirditës... në jug të lumit Drin. (Tani lind pyetja: ku ka këtu “Dukagjini i vjetër?” (fa. 281). Po kështu në f. 328 ... “viset në jug të lumit Drin që sot quhet nahija e Dukagjinit.”.. Pra shtesa “D. I VJETËR” është një sajese. Kështu, Puka dhe Mirdita (Malet e Dukagjinit). Kurse Dukagjinin e mbi Shkodrës dikush filloi ta quajë Dukag-

• Ky udhëtim u bë më 1863 me porosi të Akademisë Perandorake të Shkencave prej HAHN, (JOHAN GEORG von HAHN, albanolog i shquar, 1811 – 1869), Konsull Perandorak dhe mbretëror për Greqinë Lindore me seli në JANINË, shtypur te “GEER”, Tiranë, 2001, i përkthyer nga Pjeter Radiqi, 152- 153). Botimi në kuadrin e 155 –vjetorit të vdekjes.

jini i Ri. Po ky i ashtuquajtur i Dukagjini i Ri ishin banorët e Midhës (Midha -Shala Vendit - Dukagjin). Pra edhe popullsia e Midhës, pjesë e së cilës hyri në Pult kufi me Malësinë e Madhe, duke u njohur me emrin Dukagjin, emër i vendlindjes së tyre. Kështu, as ky Dukagjin nuk mund të quhet “I RI”, siç ka pasë pretendime.

“Fshat i Ikballes, (IBALLËS) vazhdon HAN, përfshin gjithsej gjashtëdhjetëepesë (65) shtëpi katolike dhe njëzetë (20) shtëpi muhamedane (myslimane: Zotni e Buçaj) dhe bën pjesë në famullinë e Fierzës. Ikballasit dhe fqinjët e tyre më të afërt e quajne Lagjen e tyre kryesore të përshkruar më sipër KJUDAT që do të thotë qytet (GJYTET, qytezë) dhe simbas thëniesve të Don Engjëllit dhe të Sulejman Beut që përkonin me njëra tjetrën, këtu ekzistojnë ende mbeturinat kryesore të mureve rrethuese, të cilat përbëhen nga gurë gëlqerorë dhe gurë shkëmborë (të pagëdhëtur.) Ky pohim është shumë domethënës për atë që don t’u referohet burimeve historike të këtij albanologu të shquar, i cili jo rastësisht shpjegon se Ikballasit dhe fqinjët e tyre më të afërt e quajnë lagjen e tyre KRYESORE”, ku lartësohej KULLA e hijshme e Sulejman Agës; ku aty afër ishte edhe xhamia me një minare të vogël. (Hahn - Udhëtim nëpër viset e Drinit....1863, f. 152). Pra Lagja KRYESORE e Iballasve ishte aty në lagjen e Zotnive, por që Gjeloshi nuk don ta pranoi dhe e quan gjithnjë LAGJE KABASH, emërtim i kohës së regjimit komunist, me qëllimin e keq që të zhduket emri tradicional. “ZOTNI”. Për më tepër nuk e përmendim as në Librin “SHKOLLA E IBALLËS”... duke shmangur qëllimisht rolin historik të kësaj Lagje Zotnish.

Këtu ka vend për të tërhequr vëmendjen e lexuesve dhe të studiuesve për faktin se me spekulimet që bëjnë të ashtuquajturit studiues (mediokër), jo rastësisht duan që për qëllimet e tyre të mbrapshita t’i ringjallin konfliktet e para 120 vjetëve për djegjen e shkollës së Iballës, hapur më 1903....duke theksuar se populli i Iballës ...i ditka me emra konkret, se kush e ka djegur...,por nuk i përmendka gjoja për modë!!! Më e keqja qënka se merret guximi për të akuzuar

edhe brezin e katërt pasardhës i keqbërësve. që nuk e paska harruar mllëfin e djegjes! Këtu dredhohet për të mos marrë fajësinë e atyre që dogjën dy shtëpija muslimanësh në lagjen Buçaj dhe më pas edhe kullën e Niman Agës në Lagjen e Zotnive! Mandej dilet haptas kundër meje (Xh. Meçit), që paskam ba genocide !!! në Iballë, pra duke përdor kundër fjalë bombastike, që nuk jua di kuptimin (i shkreti!) Bile shkohet deri aty sa t’u bëjë thirrje dy familjeve Pemati e Mirakaj, për të mendur si “reaksonarë” për shtrirjen e rivalitetit mes tyre deri në djegjen e Shkollës Iballe.! Që të ngrenë aktpadi (!), edhe pse përmenda emrin e të ndërjet Kolë Biba si mësuesi i dytë i kësaj shkollë, (1918), aq sa pas tre muajsh u shkarkova nga dejtari i kabinetit pedagogjik dhe u caktova mësues i thjeshtë deri sa dola në pension (1991). Për më tepër, për Kolë Bibën, me fotografi, kam shkruar për organizimin e luftës në Koman (941), ku mbet i plagosur, kur forcat serbe donin ta sulmonin prapa shpine Shkodrën. (Xh. M. - Komani...Shkodër , 2019, f. 88-89).

Më 20 prill ndërsa, ishim në Akademinë përkujtimore me rastin e 105 –vjetorit të lindjes të general Rr. Parllakut - Hero i Popullit e Nderi i Kombit, vepërimtari e organizuar mjaft mirë nga OBVL dhe konkretisht nga Sekretari i saj i Përgjithshëm, Zotni Halil Rama, “Mjeshtër i Madh”, në mbyllje, në oborrin e Akademisë së Shkencave, i shquari Sefer Pashai më pyeti për pleqërinë që po tregohet bujare me mua. Po, i nderuari kolonel Sefer Pasha, publicist e shkrimtar i mirënjohur! Me një farë humori buzagaz e mbylli prerë bisedën : “Po, po, ku ka lisa...ka edhe shkurre . Të shkretat, duke u hedhur e përdredhur mundohen të maten me lisat, po, ja që shkurre se shkurre mbesin!”

Sidoqoftë Libri “Shkolla e Iballës në 120 –vjetorin e saj” duhet parë si përpjekje për ta pasqyruar sa më të plotë këtë përvjetor, i cili qe përgatitur dhe realizuar madhërisht nga Zotni Dedë Maluta, i ndihmuar prej një komisioni të përkushtuar, duke mbetur kështu shembull për përvjetorë të tillë shkollash.

KUJTESË

Ra ky mort e u pamë për Profesor Kristaq Muskën

Sefer PASHA

Shkak për këtë shkrim u bë një telefonatë prej mikut tim të rinisë Baki Gjergji. Unë sa isha kthyer nga një udhëtim i largët. Nuk kishte shumë kohë që ishte ndarë nga jeta djali i kolegut tonë Thoma Muska nga fshati Goranxi i Dropullit. Djali i Thomait po shkëlqente në gjimnazin "Asim Zeneli" në Gjirokastrë. Qenë bërë dokumentat për ta dërguar me studime në Francë. Kur biznesmeni Baki Gjergji ma dha këtë lajm të zi u trondita. Do doja që ky lajm të ishte penguar, rrugës ta rrëmbenin alienët, ta bënin copra orteqet, ta digjinin zjarret në pyje, ta izolonte pandemia, të pësonte arrest kardiak, të bëhej thërrime në një aksident automobilistik, të shpërthente lumi i fshehur në Malin e Gjerë e ta mbyste në Virua, një cunam ta tërhiqtë tutje në oqean, asteroidi ta shkërmoqte qysh në qiell pa ju afruar tokës dhe Ali Pashë Tepelena Goranxinë ta kthente në një kala si ajo e Janinës, ku njerëzit të mos shkonin dot për mort. Po lajmi nuk u pengua nga asgjë. Bashkë me lajmin e zi Baki Gjergji më dërgonte dhe një fotografi të vitit 1982. Baku dhe Krisaqi kanë qenë në avllinë e Thoma Muskës në Goranxi. Shoferi i zonave të kufirit Mersin Lluri e ka bërë shkrepjen. Unë doja ta takoja Kristaqin. Po shkruaja një libër për atin e tij Thoma Muskën. Gjithnji mendoja se Kristaqi duhet të ishte në Paris, Athinë ose në Amerikë. Por ai paska qenë në Tiranë. Në bibliotekën time duhet të kem një libër që ma ka dhuruar Kristaqi gjimnazist. Ishte libri "Njeriu me karafil" i poetit grek Janis Ricos. Me sa mbaj mend Kristaqi në faqen e parë të librit ka hedhur vetëm firmën e tij. Libri ka qenë i vogël. Atë e kishte përkthyer Aleks Çaçi. Nuk e di nëse do ta gjej në mes të librave të mi në bibliotekën personale. Dua të shikoj vetëm firmën e tij në librin e vjetër. Kristaqi i pëlqente vargu i poetit Janis Ricos: - "Komunizmi është rinia e botës". Ai e donte shumë Ricosin. Më fliste për poezitë që Ricosi i shkroi në Makroniz ku ai qe i burgosur. Poezitë në dorëshkrim i futi në një shishe të cilën e vulosi dhe e futi nën tokë në gusht dhe shtator të vitit 1949. Ato i zhvarrosi në korrik të vitit 1950.

Kristaqi e vlerësonte të atin Thoma Muskën, i cili kishte emër të mirë si ekonomist. Mua Thomai ma ka treguar me dhjetra herë se të parët e tij ishin karvanar mushkash. Me karvanet e mushkave bënin tregëti deri në Selanik. Prandaj dhe mbiemri i kishte mbetur "Mushka". Kështu e kemi në regjistrin e gjëndjes civile më thoshte me të qeshur gojëmbli Thoma Muska. Ma



kërkuar mësuesit në Goranxi dhe unë ja hoqa bashkëtingëlloren "h" mbiemrit Mushka. Dhe ai u mbeti fëmijëve "Muska". Katërgjyshi zilet e mushkave i kishte të dredhura në flori. Para se të vdiste të gjitha zilet e mushkave i depozitoi në një bankë të Janinës. Janë pasuri e madhe më thoshte Thomai. Po i humbën. Kemi njerëz në Greqi. I kemi dhe dokumentat. Po ne jemi familje e lidhur me partinë e Enver Hoxhës.

Tregimet e Thoma Muskës i diskutuam me Kristaqin, i cili në ato vite ishte 16 vjeç. Kristaqi lexonte letërsi, por nuk kishte asnjë priirje për tu bërë shkrimtar. E njihnin të gjithë poetët e jugut që nga Pano Çuka, Arben Duka, Mihallaq Qillari, Agim Mato, Thanas Dino, Petro Çekrezi, Roland Çene, Valentina Mosko dhe deri tek Moikom Zeqo, i cili banonte në Durrës, por vinte në takimet e krijuesve të Gjirokastrës se ishte nga Libohova. Kristaqi i ri dëgjonte çudira prej krijuesve gjirokastritë. Qindra pyetje më pati bërë për një pikturë, e cila reklamohej në faqen e murit të hotelit të tur-

izmit. Për pikturën pikasojane kishin filluar debatet. Punëtori Operativ i Sigurimit të Shtetit, që mbulonte qytetin, thoshte se si mundej të përjetësohej një femër, e cila është e dashura e piktorit.

Ajo është e bija e një armiku klase nga lagja "Palorto". Ç'është kjo luftë më thoshte Kristaqi? Ajo është pikturë. Femra në portret as nuk fletë dhe as nuk thotë se e bija e kujt është? Luftë klase për një portret që nuk ka as emër dhe as mbiemër. Unë e sqaroja me durim, por ishte e pamundur. Dhe Kristaqi heshtëte. Heshtja të nderon i thoshte papua[Thoma Muska].

Dhe kujtimet nuk kanë të sosur. Si bir i një dropulliti të varfër qe shumë i sertë me veten. Nga këto informacione që kam më thonë se kur ishte student në Paris i kishin kërkuar që të qëndronte atje e të jepte leksione. Por qe e pamundur. Ku ta linte Thomanë që e nderonte e gjithë Gjirokastra? Po t'i thoshin se Kristaqi është arratisur në Francë ai do ta vriste veten. Por ku i dihet? Nëse do të kishte qëndru-

"Ju që jeni gjallë, të vdekurit kujtoni"

Viktor Hygo

ar në Francë mbase do të ishte gjallë. Me Kristaq Muskën që ishte një lule jasemini nga të malit të Buretos u ndava kur ai ishte në vitin e tretë të gjimnazit. Unë ika me punë në verilindje. Karrierën e Kristaqit e ndiqja nga larg. Prej vitit 1980 deri në vitin 1985 ai studjoi dhe u pais me disa diploma në Paris. Nuk futen dot në rresht as në rrafshin gramatikor. Fliste dhe shkruante në shtatë gjuhë të huaja. I mbrojti të gjitha gradat shkencore deri sa mori dhe titullin Profesor - Doktor në Universitetin e Parisit. Punoi me hovëzim dhe thellësi të trefishtë mirfilli edhe kur në Shqipëri e transferuan në Fier pa u demotivuar. Si lektor mes studentëve ndërthuri dëndurazi yjësini e universitetit të tij. Si sistematikjen edhe në kohën e epërme i mposhti shajnitë mes kaosit të vitit 1977. Edhe pse ju krijua shansi me emojone të skjashme ai nuk e mori familjen dhe nuk shkoi në Paris, ku gjithçka e kishte gati.

.... Shënimet për jetën e ndërpre të Profesor Kristaqit nuk po i mbyll dot. Dhe e pyes veten: - Ky Kristaqi që paska kaq vjet në Tiranë si nuk u kujtua për mua? Përgjigjen e kam në majë të gjuhës. Kristaqi nuk më ka mbajtur mend. Ai universali i ngrysur në mes të dijetarëve të Parisit as nuk e imagjinonte dot se dikur në rininë e tij kishte njohur një shok të Papos që shkruante poezi. E sjell ndër mend kur bashkë me Thomanë kishim shkruar në Prongji, ku kishte familjen Mersin Lluri. Ishte dhe Kristaqi. Në një çast të drekës Mersin Lluri i tha: - Do të na harrosh more Kristaq. Thonë që Parisi nuk mbaron kurrë. Këta që kanë qenë me studime molloisin se Parisi nuk ka fund. Ndërsa unë për t'i bërë qejfin i kujtova atë që kishte thënë Aleksandri i madh: - "Po ti teket, Parisi edhe marroset".

Krisaq Muska riosh pati galaksinë e tij edhe si gjeokimist i mahnitshëm. Nga ky pikëvështrim ja vlen të përmedim atë që e thonë edhe në Goranxi se "ra ky mort e u pamë". Në këtë muranë të zeze ferri apokaliptik tani mbledhim dhe kujtojmë muzën e shkencëtarit. Kristaqi imazhin nuk ja thyen as intrigat zyrtarake në fije të perit, që e anatemuam për të gjetur qime në vezë. Idhujtari shenjtor i mbajti piklidhjet mes Parisit dhe Goranxisë. Është e zorëshme të bësh pas vdekjes biografinë e një ylli me auerolë moderniteti. Ai rrojti përsosmërisht në kohë të komplikuar. Po a pati ndonjë dramë Kristaq Muska? Jo. E vetmja dramë e tij ishte Shqipëria. E pa me sy kur ndryshoi Goranxia. Kur ai ishte në Paris kishte parë lagje në periferi që ngjanin me Gorancinë. Por ngjarjet u rrokullisën keq e më keq në Shqipërinë e munnxët. "Parisi" i tij në Dropullin e padepërtshëm u braktis. Mbi rrasat e çatave të shtëpive të Papos[Thomait] ai ironikisht pa me sy tek kakarisin korbat.

...Vajta dhe në fakultetin ku Kristaqi ka dhënë mësim si të gjurmoja një gojëdhanë bibilke. E gjithë vepra e tij kërkon të përmbledhet e të botohet në shtatë volume. Por kush do ta sistemojë e redaktoj atë mal sa Buretua? Tragjiku mitik Kristaq Muska vdiq para kohe. Por do të kalojë dhe kjo periudhë me makthe pesimiste. Do të vijë e mëpastajmja. Asgjë nuk ka për të humbur nga vepra e dijetarit. Në fakultetin ku Profesor Kristaqi ka dhënë mësim fjalët e mira gurgullonin si ata përrenjtë e Malit të Gjerë. Dhe unë në zyrën e Kristaqit kundroja e mërmërija si në motëzime këngën që e këndonte në greqisht Papua[Thoma Muska] - /Ç'është jeta?/Hiç gjë!//Frymë e kërmë e qelbr -ë//Përveç muhabeti -të!

KUVENDI I SHTËPËZIT BESË E SHPRESË PËR SHQIPËRINË

(Vijon nga faqja 12)

Shtegu i Fushëbardhës në Labëri përpara se të futej në bannkoprovën e historisë kishte marrë bekimin e Kuvendit të Shtëpëzit. Po ashtu edhe xhephania e Cepos. Lufta në Skërficë dhe në Cepo jaë prova më e mirë e besës së Shtëpëzit e këtij kuvendi historik, që i shërbeu denjësisht çështjes kombëtare shqiptare. Kështu Lufta e përgjakshme nga 20 deri më 26 qershor 1914 në Skërficë, ku Çeta e Fushëbardhës që kishte dhe djem luftëtarë nga Zhulati, Golemi, Picari, Libohova, Gjirokastra, Delvina, Rrëzoma që në total shkonin mbi 120 luftëtarë e që komandoheshin nga Halil Sullo në shtegun e parë të Labërisë shkruan epope lavdie. Luanët flisnin me grykën e maliherit ndaj pesëqind andartësh. "Kali i Trojës", nuk mundi të mposhtë "Patkoin strategjik" të Skërficës deri në largimin e gjithë banorëve drejt Vlorës. Fushëbardha e Skërfica ngelën të lidhura pazgjidhshmërisht nëpër shekuj sikurse edhe në betejën me andartët. "Patkoin strategjik" të Skërficës e "zbuluan" për herë të parë dhe u ndeshën legjonet romake, Pirrua i Epirit tregoi muskujt në emër të forcës dhe krenarisë kaone, duke bërë që të lartësohej lavdia e forca e madhësisht ilire. Në Skërficë me marrëveshje me Papa Zhulin kaloi Boemundi, por u bë shteg i pakalueshëm për gjithë hasmët e të pabesët e Shqipërisë. Skërfica dhe Fushëbardha si bin-

jake historike në mbretërinë e Zotave. Shkalla e Bregu i Erëzës bashkë me qafën e pesë priftëre janë mbushur me legjenda e mite që i pëshqjell Lëmëthi me mistere historike. Ato janë dëshmitare nga kaluan romakë, bizantinë, venecianë, osmanë, grekë etj. Vëndasit u ndeshën me perandoritë në Gjashtë, Lëkurës, Sarandë, Delvinë, Rrëzomë në të gjithë Kaoninë. Liria, dinjteti, krenaria kanë shoqëruar në shekuj luftëtarët fushëbardhas, zhulata.. në barikadën e shekujve. Ndaj u bënë barikadë për andartët e 1914-ës, dhe ngelën në përjetësi në memorialin "Fushëbardha 2014" më i madhi në Labëri, që u kush-tohet nëntë dëshmorëve që ranë në Skërficë. Nuk harrohet "përqaftimi" bajonetë më bajonetë e thikë më thikë më pushtuesit në Skërficë. Kaonia, Labëria, Fushëbardha ecin... në rrugën e prosperitetit. Dëshmorët e djeshmja dhe e sotmja bashkë. Rruga aty këtu ndriçon nga gurët e shndritshëm fosforikë, që Fushëbardha i ka me bollëk. Ngjan si bulevard pedonaleje e ndriçuar me drita të "mbira" nga dheu. Ato rezatojnë vetëm lartë. Dëshmorët e 14-ës, luftëtarët e tjerë në Skërficës nuk bënë pakt me dredhinë, sepse nuk u zihej besë të pabesëve. Dëshmorët u trupëzuan me kalanë natyrore të Skërficës, portën e parë të Labërisë. Ata ngelën në panteonin e kombit e memorien popullorë të Kardhiqit, Rëzomës, Labërisë, mbarë kombit shqiptar.

73 VJETORI

Krenaria e shqiptonjave te ajrit

Nga GJIN MUSA


Në pervjeterin e 73 te krijimit te Aviacionit Shqiptar regjimenti i helikoptereve te Farkes kujton me respektete ata aviatore qe falen jeten ne krye te detyres. Te perjetshem ne altarin e pavdeksis, ishin dhe mbeten krenaria e shqiptonjave te ajrit bijet e regjimentit te helikoptereve te Farkes. Aviacioni Luftarak Shqiptar eshte krijuar pas Luftes se Dytë Botërore dhe data zyrtare e krijimit te tij eshte 24 prilli i vitit 1951

NDUE MËHILL LOGU



Ka lindur më 8 maj 1940 në Brashtë të Dukagjinit. Ka mbaruar Shkollën e Mesme Ushtarake "Skënderbej", e më pas për pilot helikopteri në ish-Bashkimin Sovjetik. Ka kryer detyra të ndryshme si pilot me Klasin Dytë, deri komandant skuadrilje e Zëvendëskomandant Regjimenti. Në vitin 1983 mbaroi studimet në Akaeminë e Mbrojtjes, pas së cilës u emërua Shef Armatimi për repartin. Vdiq në krye të detyrës me 13 shtator 1986 gjatë drejtimit të qitjeve me granata dore, ku u hodh mbi një granatë për të shpëtuar jetën e të pranishëmve në poligon. Me vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 258, datë 22.04.1996 është shpallur "Dëshmor i Atdheut". Prehet në Varrezat e Dëshmorëve të Kombit në Tiranë.

AGRON HASAF GALANXHI



Ka lindur më 11 janar të vitit 1939 në Gjirokastrë. Studioi për pilot në ish-BRSS. Gjatë karrierës ushtarake kreu detyra të ndryshme deri zëvendës-


komandant skuadrilje. Ishte pilot i Klasit të Dytë. Ra në krye të detyrës në katastrofën ajrore të 22 nëntorit 1989 në rajonin e Himarës, në përpjekje për të shpëtuar një grup studentësh e pedagogësh të Institutit të Lartë Bujqësor, që kishin pësuar një aksident automobilistik. Me vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 228, datë 22.04.1996 është shpallur "Dëshmor i Atdheut". Prehet në Varrezat e Dëshmorëve të Kombit në Tiranë.

ENVER OSMAN HAKA



Ka lindur më 14 prill të vitit 1956 në Petrelë të Tiranës. Mbaroi Akademinë e Forcave Ajrore për teknik aviacioni dhe ka kryer detyrën e teknikut-fluturues në Regjimentin e Farkës me helikopterët Mi-4. Ra në krye të detyrës në katastrofën ajrore të 22 nëntorit 1989 në rajonin e Himarës. Me vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 228, datë 22.04.1996 është shpallur "Dëshmor i Atdheut". Prehet në Varrezat e Dëshmorëve të Kombit në Tiranë.

PANDELI JORGO ZHUPA



Ka lindur më 15 shtator të vitit 1946 në Jergucat të Gjirokastrës. Ka mbaruar Akademinë e Forcave Ajrore dhe ka kryer detyrën e teknikut-fluturues me helikopterin Mi-4. Gjatë një misioni humanitar më datën 22.11.1989, ra në krye të detyrës. Me vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 228, datë 22.04.1996, është shpallur "Dëshmor i Atdheut". Prehet në Varrezat e Dëshmorëve të Kombit në Tiranë.

TAFIL NJAZI AGAI



Ka lindur më 10 janar të vitit 1950 në Gjuzë të Tepelenës. Ka mbaruar Akademinë e Forcave Ajrore për pilot dhe ka kryer detyra të ndryshme deri komisar skuadrilje. Ra në krye të detyrës me 22.11.1989, së bashku me pilotët dhe teknikët e tjerë që shkuan në ndihmë të studentëve e pedagogëve të Institutit të Lartë Bujqësor. Me vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 228, datë 22.04.1996 është shpallur "Dëshmor i Atdheut". Prehet në Varrezat e Dëshmorëve të Kombit në Tiranë.

VANGJEL VANGJEL POSTOLI



Ka lindur më 19 mars të vitit 1940 në Berat. Ka mbaruar studimet në ish-Bashkimin Sovjetik për pilot dhe Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm në Tiranë. Kreu detyra të ndryshme deri në atë të Zëvendëskomandantit të Regjimentit. Ishte pilot i Klasit të Dytë me helikopter. Ra në krye të detyrës me 22.11.1989 së bashku me pilotët e teknikët e tjerë që shkuan në ndihmë të studentëve e pedagogëve të Institutit të Lartë Bujqësor, pas një aksidenti automobilistik që ata kishin pasur në Llogara, Himarë.

Me vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 228, datë 22.04.1996 është shpallur "Dëshmor i Atdheut". Prehet në Varrezat e Dëshmorëve të Kombit në Tiranë.

VELEDIN DELO RESULI

Ka lindur më 26 nëntor 1950 në Vlorë. Mbaroi Akade-



minë e Forcave Ajrore në Vlorë për pilot dhe kryente detyrën e komandantit të ekuipazhit me helikopter. Ra në krye të detyrës në katastrofën ajrore të datës 22.11.1989 në Himarë së bashku me ekuipazhin. Me vendim të Këshillit të Ministrave Nr.228, datë 22.04.1996 është shpallur "Dëshmor i Atdheut". Prehet në Varrezat e Dëshmorëve të Kombit në Tiranë.

VANGJEL ÇONDI



Është lindur në Sarandë në vitin 1960, ishte pjesë e ekuipazhit të pilotëve të helikopterit qeveritar Bell 222, rrëzuar më 16 korrik 2006, gjatë transportimit të politikanit Gramoz Pashko për mjekime në Itali. Më datë 20 nëntor 2006, presidenti i Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu dekoroi Vangjel Çondi (pas vdekjes) me "Medalja e Artë e Shqiptonjës".

DEMUSH HEBA



Është lindur në vitin 1960, ishte pjesë e ekuipazhit të pilotëve të helikopterit qeveritar Bell 222, që transportonte politikanin Gramoz Pashko. Më datë 20 nëntor 2006, presidenti i Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu dekoroi Demush Heba (pas vdekjes) me "Medalja e Artë e Shqiptonjës".

QEMAL KONDI



Është lindur në vitin 1950, vdiq në vitin 2006 gjatë transportimit në Itali me helikopter të politikanit Gramoz Pashko. Qemal Koni iu akordua me datë 20 nëntor 2006, "Medalja e Artë e Shqiptonjës" (pas vdekjes), nga presidenti Moisiu. Qemal Kondi përshkruhet nga kolegët e tij pilotë, si një teknik i përsosur dhe një prej profesionistëve të aviacionit shqiptar. Ai prej shumë vitesh kujdesej për mirëmbajtjen dhe kontrollin e helikopterit që shërbente për personalitetet shtetërore shqiptare.

FLORAN DELIA



Është lindur më 01.10.1973 në Dibër. Kreu studimet në Akediminë Ushtarake "Skënderbej" nga ku u diplomua në vitin 1996 si pilot. Nga viti 2004 e në vazhdim ka kryer detyra të ndryshme në Bazën Ajrore Farkë, si pilot ekuipazhi i parë në BO105 dhe komandant ekuipazhit SAR. Kapiten Delia ka kryer kurse kualifikimi brenda dhe jashtë vendit. Ra në krye të detyrës në datë 06.04.2016 si pasojë e rrëzimit të helikopterit EC 145 në Grizhdë të Malsisë së Madhe, gjatë një fluturimi stërvitor.

DONALD HOXHA



Është lindur më 17.06.1988 në Berat. Kreu studimet në Akediminë e Aviacionit të Pozzuolit në Napoli, Itali, ku e përfundoi me sukses në vitin 2011 dhe u certifikua si pilot. Pas shkollimit, u emërua pilot në Bazën Ajrore Farkë, ku shërbeu me profesionalizëm e devotshmëri. Detyra e fundit ishte pilot SAR në grupin e helikopterëve në Bazën Ajrore Farkë. Kreu kurse të ndryshme kualifikimi, brenda dhe jashtë vendit, për pilotimin e helikopterëve të tipit EC 145 (SAR). Ra në krye të detyrës në datë 06.04.2016 si pasojë e rrëzimit të helikopterit EC 145 në Grizhdë të Malsisë së Madhe, gjatë një fluturimi stërvitor.

FOTOREPORTAZH



105 VJETORI I LINDJES

ARRAHMAN PARLLAKU

Herói i Popullit dhe Nderi i Kombit
GJENERALI QË BËRI EPOKË



My Family

ARRAHMAN PARLLAKU
Herói i Popullit dhe Nderi i Kombit
GJENERALI QË BËRI EPOKË

AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË

Outdoor Picnic

PRILL 2024
NDERIMI PËR
"NDERIN E KOMBIT"
ARRAHMAN PARLLAKU

Folësit në tubim

Our backyard



TESTAMENTI I ATDHE DASHURISË

www.jshqiptare.com

London

105 VJETORI I LINDJES

ARRAHMAN PARLLAKU
Herói i Popullit dhe Nderi i Kombit
GJENERALI QË BËRI EPOKË



Mirënjohje e lavdi etërve themelues

Aleks Buda	Dhimitër Shuteriqi	Hekuran Mara	Mentor Pe
Androli Kostallari	Egrem Çabej	Kole Paparisto	Petraq Pll
Bajram Preza	Fejzi Hoxha	Kole Popa	Petrit Rado
Bedri Dedja	Foto Cami	Luan Omari	Seladin Beki
Besim Daja	Hajredin Kombaro	Mahir Dogan	Sotir Kunes

